



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



Përfshirja e shoqërisë civile në procesin e integritit evropian

DOKUMENT POLITIKASH

2020



QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT



PËRFSHIRJA E SHOQËRISË CIVILE NË PROCESIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

Ky studim u përgatit nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në kuadër të projektit “Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB), është një iniciativë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).

QENDRA KOMBËTARE BURIMORE PËR SHOQËRINË CIVILE

Email: info@resourcecentre.al

Website: www.resourcecentre.al

Rruga e Elbasanit, Godina Park Gate, Kati I 10-të,
Ap. 71 / 73, PO BOX 2418/1
Kodi Postar 1010, Tirana, Albania
Tel: +355 4 2254881

TABELA E PËRMBAJTJES

03

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

05

HYRJE: SEKTORI I SHOQËRISË CIVILE
NË SHQIPËRI

10

PROCESI I INTEGRIMIT NË BE:
PLATFORMA E PARTNERITETIT DHE
TRYEZAT E KËSHILLIMIT

Metodologjia e re e Zgjerimit e BE dhe hapja e negociatave

15

EKSPERIENCA NGA VENDET E
RAJONIT: MËSIMET E NXJERRA DHE
PRAKTIKAT MË TË MIRA

Rasti i Bullgarisë dhe Rumanisë: Vendosja e kushteve pas
anëtarësimit në BE

Rasti i Kroacisë: procesi i integrimit që u karakterizua nga
mospërfshirja e shoqërisë civile

Rasti i Serbisë – si vend që ka hapur negociatat me BE-në

Rasti i Maqedonisë së Veriut: si vendi në të njëjtën fazë me
Shqipërinë

24

PËRFUNDIME

25

REKOMANDIME

28

ANEKSE

Aneks 2

40

BIBLIOGRAFIA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin European prej 30 vitesh është projekti më madhor i shtetit dhe shoqërisë shqiptare, që lidhet drejtpërdrejt me procesin reformues dhe ngritjen e institucioneve demokratike në vend. Ky proces, ku të gjithë janë të interesuar dhe të ndikuar, nuk mund të jetë monopol i vetëm një sektori dhe aktori, por përkundrazi si kusht thelbësor për suksesin dhe arritjen e qëllimeve të tij ka: gjithëpërfshirjen aktive. Për ta arritur atë duhet pra të krijohen hapësira informimi, bashkëpunimi dhe angazhimi për të gjithë aktorët si shtetërorë, ashtu dhe ata jo-shtetërorë si shoqëria civile, komuniteti i biznesit, akademja, media dhe grupe të tjera të interesit.

Në këtë prizëm, shoqëria civile luan një rol kyç në monitorimin, konsultimin dhe vlerësimin e veprimeve, masave dhe zhvillimeve në kuadër të procesit të integritit europian të vendit. Shqipëria gjendet në një fazë të rëndësishme të këtij rrugëtimi, ajo pret zyrtarisht hapjen e bisedimeve me BE-në për anëtarësimin, që do të realizohet vetëm pasi të zhvillohet Konferenca e Parë Ndërqeveritare. Procesi i negociatave që përkthehet në negocimin e 33 kapitujve të Acquis së BE me dy palëve: asaj europiane me atë shqiptare, kërkon përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë, ku shoqëria civile e pajisur me kapacitete dhe ekspertizë, do të duhet të luajë rolin e saj monitorues dhe vlerësues, si dhe të jetë pjesë në këshillimin, diskutimin dhe informimin e kësaj faze.

Për këtë qëllim ky dokument politikash i realizuar nga hulumtuesit e Lëvizjes Europiane në Shqipëri në kuadër të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, një projekt i financuar nga Bashkimi European dhe zbatuar nga Partnerët për Ndryshim dhe Zhvillim në Shqipëri, synon të trajtojë ku qëndron shoqëria civile në këtë proces, cili është roli i saj por edhe sfidat që ajo përballlet në mjedisin shqiptar duke analizuar dy aspekte me rëndësi: bashkëpunimin me aktorët shtetërorë, dhe kapacitetet e saj për të realizuar funksionet e parashikuara në mënyrë eficiente dhe të suksesshme. Dokumenti në pjesën e dytë bën një pasqyrim të strukturës negociatore të ngritur në vend dhe analizon më në detaje rolin e parashikuar për shoqërinë civile duke vlerësuar zhvillimet e arritura deri më tani. Ndërkohë në pjesën e tretë merren në shqyrtim procesi i negociatave dhe i anëtarësimit në BE për disa vende të Bashkimit European dhe vende kandidatë të Ballkanit Perëndimor. Përzgjedhja e tyre nuk ka qenë rastësore, por janë mbajtur parasysh dy elemente kryesore: 1) ngjashmëria e tyre me vet rastin shqiptar. Këto vende kanë afërsi jo vetëm gjeografike dhe historike, por gjejmë të

përbashkëta dhe në proceset e tyre demokratike dhe politikëbërëse, ku afërmendsh vihen re dhe problematika e sfida të përbashkëta. Kjo lidhet me arsyen e dytë dhe qëllimin kryesor të analizës: 2) me atë se çfarë mësimesh mund të nxjerrim ne nga eksperiencat e këtyre vendeve, të cilat janë sot Shtete Anëtare të Bashkimit European si Bullgaria, Rumania dhe Kroacia; apo janë duke negociuar si Serbia apo janë në pritje të hapjes së negociatave si Maqedonia e Veriut.

Në fund dokumenti ofron dhe një sërë rekomandimesh si për aktorët kombëtarë apo rajonalë si qeveritë ashtu dhe shoqëria civile, por edhe për vet Bashkimin European si një palë e rëndësishme në të gjithë këtë proces, por që pas eksperiencave të mëparshme duhet të fokusohet në veçanësitë e secilit vend në mënyrë që procesi të jetë i përshtatshëm.

Për realizimin e këtij dokumenti është realizuar një punë kërkimore cilësore disa mujore bazuar në raportet, dokumentet dhe vendimet të lidhura më tematikat e trajtuara në këtë studim. Dokumenti ka synuar që jo vetëm të listojë fakte e të pasqyrojë zhvillimet e ndodhura në këtë kuadër, por të ofrojë dhe rekomandime e vlerësime mbi këto zhvillime dhe si mund të përmirësohet procesi duke përfshirë të gjithë aktorët e duke nxjerrë mësim nga eksperiencat e vendeve të tjera me aspekte të përbashkëta me Shqipërinë.

1. Hyrje: Sektori i shoqërisë civile në Shqipëri

Me hapjen e negociatave për integrimin në BE në mars të vitit 2020, Shqipëria bëri kështu një hap tjetër për të përmbushur aspiratat europiane të vendit. Tani e gjithë vëmendja është përkushtuar të përgatitja për Konferencën e Parë Ndërqeveritare mes BE dhe Shqipërisë, që nënkupton dhe fillimin real të procesit të bisedimeve. Duke marrë parasysh një momentum kaq kyç për Shqipërinë, bëhet e kuptueshme që për këtë proces duhet që të jenë të përfshirë të gjithë sektorët dhe aktorët, si institucionet publike (në nivel lokal apo qendror), shoqëria civile dhe sektori privat, akademia dhe partnerët socialë, rinia dhe media, për tu përfshirë njëkohësisht si kontribuues, dhe si grupe interesi të prekura e të ndikuara nga ai.

Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve publike është një nga elementet me rëndësi të përmendur edhe në dokumentin udhëzues për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, realizuar nga Drejtoria e Zgjerimit e Komisionit Europian¹. Sipas këtyre udhëzimeve, krijimi i mjedisit mundësues është kyç për organizatat e shoqërisë civile, dhe për këtë është e nevojshme fuqizimi i kapaciteteve të tyre, për ti bërë ato më të pavarura, transparente dhe të qëndrueshme financiarisht. *Udhërrëfyesi për politikën e qeverisë drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023* (i rishikuar) u miratua më 25.07.2019, nga Vendimi i Këshillit të Ministrave numër 539, e nënvizon pikërisht krijimin e një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri. Ky është një parakusht për një demokraci të qëndrueshme, ndërkohë që komunikimi dhe bashkëpunimi janë thelbësorë për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse. Në këtë drejtim, udhërrëfyesi ka identifikuar tre prioritetet strategjike, ku një prej tyre është: *Bashkëpunimi i institucionalizuar qeveri – shoqëri civile*.² Gjithsesi, Raporti i Komisionit Europian për vitin 2020 për Shqipërinë, është shprehur se nuk është bërë progres sa i përket këtij prioriteti.

Në Shqipëri numërohen më shumë se 7 600 organizata jo fitimprurëse të regjistruara³, ndërkohë që të dhëna të tjera tregojnë që ky numër mund të ketë shkuar në mbi 10 mijë organizata⁴. Por pavarësisht kësaj, numri i lartë nuk është detyrimisht garanci që këto organizata të jenë të zhvilluara e të fuqizuara mjaftueshëm. Nëse analizohet rasti shqiptar, mund të vihet re madje që dhe pse ka një numër kaq të madh organizatash ato mbeten akoma jo shumë të fuqishme, pasi angazhimi i tyre në vendimmarrje dhe monitorimin e procesit

¹https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/doc_guidelines_cs_support1.pdf

² Vendimi Nr. 539, datë 25.7.2019, fq. 4: [http://www.amshc.gov.al/web/doc/Udherrefyesi-2019-rishikuar-\[EN\].pdf](http://www.amshc.gov.al/web/doc/Udherrefyesi-2019-rishikuar-[EN].pdf)

³ Ibid, fq 4. Sipas të dhënave të Gjykatës së Shkallës së parë publikuar në shkurt 2018, kanë qenë të regjistruara gjithsej 7 580 organizata.

⁴ Sopoti, R., dhe Agolli, A., Hartëzimi dhe vlerësimi i rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Tiranë, Shqipëri 2019, fq. 8: <https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2019/12/Hart%C3%ABzimi-dhe-vler%C3%ABsimi-i-Rrjeteve-t%C3%AB-OSHC-ve-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri.pdf>

politik-bërës nuk është realizuar ende plotësisht. Si pasojë, *“shumica e OSHC-ve janë të vogla dhe jo-funksionale dhe pa personel pas emrave kryesorë, duke e bërë të pamundur vazhdimin e veprimtarisë së tyre midis projekteve.”*⁵ Një shoqëri civile e dobët përgjithësisht ka këto tipare: nivel i ulët i anëtarësimeve; nivel i ulët pjesëmarrjeje; nivel i ulët besimi tek OSHC dhe përfshirje e kufizuar në procedurat konsultative, edhe pse kjo mund të parashikohet nga ligji i vendit në fjalë.⁶ Mund të thuhet, që shoqëria civile shqiptare karakterizohet nga këto elemente, të cilat vërtet mund të gjenden në nivele të ndryshme, por mbeten pjesë përbërëse e mjedisit në të cilin operojnë ato. Siç theksohet dhe nga Raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2020: *“Nuk ka progres sa i takon zbatimit të udhërrëfyesit për një mjedis mundësues për shoqërinë civile”,* ndërkohë që: *“Duhet përpjekje madhore për të siguruar një proces konsultimi sistematik dhe të plotë me shoqërinë civile, për të pasur një dialog gjithëpërfshirës në kuadër të reformave”*. Kjo është thelbësore pasi: *“Një shoqëri civile e fuqizuar, është një komponent kyç për çdo sistem demokratik e si i tillë duhet të njihet dhe trajtohet edhe nga institucionet shtetërore.”*⁷

Një nga strukturat e rëndësishme për të arritur këtë prioritet në Shqipëri është Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile, i ngritur në 2015. Ai ka një rol këshillimor dhe synon të krijojë një hapësirë për dialog midis organizatave të Shoqërisë Civile dhe institucioneve shtetërore sa i përket temave me interes dhe reformave të ndërmarra nga qeveria. Objektivat e tij janë përcaktuar në Nenin 1 të ligjit Nr. 119/2015 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile": *“1. Krijimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, për të garantuar bashkëpunimin institucional me organizatat e shoqërisë civile në Republikën e Shqipërisë, në dobi të zgjerimit të demokracisë, konsolidimit të qeverisjes së mirë dhe rritjes së transparencës në vendimmarrjen publike, nëpërmjet përfshirjes më të mirë të shoqërisë civile në këtë proces”*. Por ky Këshill nuk po funksionon plotësisht, siç edhe raporti i KE 2020 vlerëson: *“Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile është mbledhur vetëm një herë në 2019, dhe takimi ishte jopërfshirës dhe pa asnjë plan për vazhdimësi”*. Gjithashtu, KE rekomandon që: *“Këshilli duhet të përfshijë dhe angazhojë aktorë të shoqërisë civile për të përfaqësuar opinionin e OSHC-ve në proceset politikëbërëse.”*⁸

Një tjetër strukturë e themeluar me qëllim përfshirjen e shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë jo-shtetërorë në politikëbërje është edhe Këshilli Kombëtar për Integrimin European, që shërben si struktura më e lartë këshilluese e Kuvendit të Shqipërisë për integrimin european. Ky Këshill promovon dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës mes forcave politike, institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile si dhe bën të mundur rritjen e transparencës në

⁵ Ibid, fq. 8

⁶ Pérez-SolórzanoBorrágán, Nieves, Civil Society and EU Enlargement In The Search for Europe. Contrasting Approaches. Madrid: BBVA, 2015 - <https://www.bbvaopenmind.com/en/articles/civil-society-and-eu-enlargement/>

⁷ Raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2020, fq. 12-13: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

⁸ Ibid, fq. 13: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

procesin vendimmarrës që lidhet me çështje të integritetit evropian, siç është parashikuar në Ligjin 15/2015. Në 2019, KKIE realizoi vetëm katër takime, ndërkohë që në 2020 janë realizuar vetëm 6 takime, të cilat për shkak të masave anti-Covid janë zhvilluar online ose në formatin hibrid (të kombinuar). Ndërkohë që më 22 shkurt 2021, u zhvillua takimi i tij i parë për 2021.⁹

Por të dy këto organe kanë shfaqur problematika dhe mangësi. Së pari, problematik është fakti që këto mbeten mekanizma të krijuara rishtazi, jo plotësisht të konsoliduara dhe të strukturuar, që nënkupton që është e vështirë për to të arrijnë objektivat dhe synimet e tyre. Së dyti, të dy këto këshilla kanë realizuar takime sporadike dhe të rralla, duke mos qenë në të njëjtin hap dhe shpejtësi si procesi që ato monitorojnë, i cili është i vazhdueshëm e dinamik. Siç edhe u përmend, Këshilli për Shoqërinë Civile është mbledhur vetëm një herë në 2019, ndërkohë që KKIE ka realizuar vetëm gjysmën e aktiviteteve që kishte planifikuar për vitin 2020.¹⁰

Një problematikë tjetër e hasur nga këto organe lidhet me faktin që ato nuk janë të përfaqësuara në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe për më tepër në nivel lokal. Kështu, sipas të dhënave është vënë re që OSHC-të lokale janë të papërfaqësuara ose shumë pak të përfaqësuara, kjo lidhur dhe me vështirësitë që ato hasin për tu përfshirë e për tu bërë pjesë e mekanizmave të tilla. KKIE ka në përbërje të tij 15 organizata të shoqërisë civile si anëtare, por asnjëra prej tyre nuk vjen nga ndonjë rajon tjetër, pra të gjitha ato kanë qendrën e tyre në Tiranë. Edhe pse duhet përmendur që disa prej tyre kanë bashkëpunim të ngushtë apo shërbejnë si rrjete bashkëpunimi për komunitetet lokale dhe organizatat në nivel lokal, fakti është që KKIE nuk ka asnjë organizatë të nivelit lokal si anëtare.¹¹

Kjo shërben për të vlerësuar edhe vet organizatat lokale dhe kapacitetet e mundësitë që ato kanë realisht për tu përfshirë në struktura të tilla. Disa mangësi që janë vënë re në këtë drejtim lidhen me një mungesë të përgjithshme informimi të organizatave por dhe komuniteteve të ndryshme në nivel lokal sa i përket procesit të integritetit. Kjo mungesë informimi, ndikon më pas në mospërfshirjen e tyre në këtë proces. Ky mbetet një element mjaft shqetësues kur është e ditur që më shumë se 70% e legjislacionit të BE në fakt duhet të zbatohet në nivel lokal. Në këtë drejtim, është e nevojshme që strukturat dhe komunitetet lokale, të kenë kapacitetet, njohuritë dhe burimet e duhura, që jo vetëm të arrijnë ta njohin dhe kuptojnë ligjin, por dhe ta zbatojnë atë në mënyrë korrekte. Roli i qeverisjes lokale gjatë procesit të integritetit evropian është specifikuar edhe në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit firmosur mes BE dhe Shqipërisë, ku ndër të tjera përmendet: *“1. Palët duhet të forcojnë bashkëpunimin për zhvillimin*

⁹Faqja zyrtare e Kuvendit të Shqipërisë: <https://www.parlament.al/DokumentalIntegrimi?integrimId=7>

¹⁰Ibid

¹¹Lista e OSHC-ve anëtare të KKIE: <https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ListaOSHCKKIE.pdf>

lokal dhe rajonal, për të arritur objektivin për zhvillimin ekonomik dhe zvogëlimin e pabarazive rajonale. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar bashkëpunimit ndërkufitar, ndërkombëtar dhe ndër-rajonal. 2. Bashkëpunimi duhet të marrë në konsideratë ato zona të cilësuar me rëndësi edhe nga legjislacioni i komunitetit në fushën e zhvillimit rajonal.”¹² Për këtë, fuqizimi dhe konsolidimi i shoqërisë civile është me rëndësi, duke u kushtuar vëmendje të veçantë aktorëve lokalë.

Shoqëria civile është një aktor kyç në monitorimin dhe mbështetjen që i bëhet punës së qeverisjes qendrore dhe asaj lokale. Sipas raportit të publikuar në 2018 nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri mbi Njësitet e Qeverisjes Lokale¹³, mungon dialogu e komunikimi mes palëve (autoritetet dhe shoqëria civile në nivel lokal). Gjithashtu komuniteti dhe organizatat nuk janë të përfshira në veprimtarinë e bashkive apo institucioneve qeverisëse lokale, dhe kjo sjell mungesë të transparencës e përgjegjshmërisë, kur ndërkohë mungesa e informacionit nuk i lejon aktorët jo-shtetërore të ngrenë mekanizmat e duhur për të monitoruar institucionet përgjegjëse. Edhe pse raporti i vlerësimi i publikuar në korrik 2020 nga BE për Bashkitë, pasqyron një përmirësim të situatës gjatë 2019, ku ka një rritje të numrit të rekomandimeve të dhëna nga OSHC-të, mbeten prezente problematikat e lidhura me forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve në hartimin e projekteve dhe në rolin e tyre monitorues. Gjithashtu raporti rekomandon përfshirjen e OSHC-ve nga ana e bashkive në procesin e politik-bërjes vendore dhe konsultimit publik¹⁴, duke nënkuptuar që kjo mbetet akoma një sfidë sidomos për OSHC-të në bashkitë më të vogla, ku mungon edhe sensibilizimi dhe informimi për pjesëmarrje.

Por mungesa e bashkëpunimit me autoritetet shtetërore dhe mospërfshirja e OSHC-ve për shkak të mungesës së kapaciteteve apo informacionit, nuk janë të vetmet sfida që organizatat në nivel lokal përballen sot në Shqipëri. Disa sfida të tjera të përmendura dhe nga raporti i 2018 janë dhe: specializim i kufizuar, mungesa e ekspertizës dhe burimeve njerëzore duke i kthyer ato në aktorë të pafuqishëm për të ndikuar në politikëbërje dhe në vendimmarrje. Ka raste ku dhe numri i organizatave që operojnë në një zonë apo bashki të caktuar të jetë mjaft i vogël ndërkohë që strukturat këshilluese dhe përfshirëse mungojnë totalisht në shumë bashki.

BE e konsideron një shoqëri civile të fuqizuar dhe të përfshirë si një karakteristikë e qeverisjes demokratike në Union. Për këtë fuqizimi i OSHC-ve është një qëllim i shprehur në Librin e Bardhë (White Paper) të Qeverisjes Europiane të 2001, duke rekomanduar që qeverisja e BE-së

¹²MSA Shqipëri- BE: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22009A0428\(02\)&from=EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22009A0428(02)&from=EN)

¹³ Delegacioni i BE në Shqipëri, Bashkitë në Procesin e Integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Raporti I, 2018, fq. 9: <https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/filedownload.pdf>

¹⁴ Ministria e Brendshme dhe Delegacioni i BE në Shqipëri, Bashkitë në Procesin e Integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian - Raporti i Vlerësimit për vitin 2019, korrik 2020, Tiranë, fq. 33-35: https://docs.google.com/viewerng/viewer?url=https://www.bpe.al/sites/default/files/documents/Bashkite%2520ne%2520Procesin%2520e%2520Integritit%2520AL_0.pdf

duhet të jetë gjithëpërfshirëse, e hapur dhe e përgjegjshme. Dokumenti nënvizon nevojën për fuqizimin e pjesëmarrjes civile dhe dialogun, elemente që përçohen edhe në Strategjinë e Zgjerimit të BE-së.¹⁵ Pjesëmarrja gjithëpërfshirëse dhe e hapur, janë gjithashtu pjesë e vet Traktatit të Lisbonës.

Në lidhje me shoqërinë civile në vendet kandidate, BE luan një rol mbështetës dhe synon të arrij dy qëllime madhore: Së pari, këto organizata konsiderohen si aktorë thelbësorë që do të shtyjnë vendin për të përmbushur kriteret e vendosura në kuadër të shtetit ligjor, të drejtat e njeriut dhe krijimin e një demokracie funksionale. Së dyti, përfshirja e organizatave të shoqërisë civile vlerësohet si një mjet që mund të 'thellojë' njohuritë e qytetarëve mbi procesin reformues që vendi duhet të zbatojë në mënyrë që të përmbushë kriteret për tu anëtarësuar në Bashkimin Europian.¹⁶ Vlerësohet kështu që vetëm nëse shoqëria civile kthehet në një aktor të fortë dhe aktiv, procesi i vendimmarrjes së vendit në kuadër të integritit europian finalizuar me firmosjen e traktatit të anëtarësimit në BE, do të jetë një akt i mirëpranuar nga e gjithë shoqëria; një shoqëri kjo, që nëpërmjet politikave përfshirëse është e mirëinformuar dhe ka kontribuar gjatë gjithë këtij procesi.

Sa i përket politikave të zgjerimit, BE është angazhuar në promovimin e përfshirjes së shoqërisë civile të vendeve kandidate gjatë procesit të aderimit, ku një element i rëndësishëm është mbështetja financiare që po u jepet OSHC-ve në këto vende, me synimin që ato të kenë mundësi të luajnë rolin e tyre monitorues gjatë bërjes dhe zbatimit të politikave. Për këtë, që nga 2008 është ngritur Instrumenti për Shoqërinë Civile (CSF) në kuadër të programit të Asistencës së Para-Aderimit (IPA). CSF operon duke u bazuar në tre shtylla kryesore: 1) mbështetje e nismave civile dhe ngritje e kapaciteteve; 2) mbështetje për nisma e aktivitete të ndërmarra në bashkëpunim mes OSHC-ve të rajonit apo dhe me Shtetet Anëtare të BE dhe 3) programi 'People-2-People' që mbështet vizita studimore në institucionet e BE-së dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të mira.¹⁷

Për periudhën 2018-2019, BE zbatoi programin e Instrumentit për Shoqërinë Civile dhe Medias, duke kontribuar 112 milion e 600 mijë Euro. Vendet që përfituan nga ky program janë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia. Për Shqipërinë buxheti i parashikuar ishte 5 milion e 800 mijë Euro për të dy vitet që mbulon programi, viti 2018 dhe 2019.¹⁸ Objektivat specifike të programit për shoqërinë civile në Shqipëri përfshinin si përmirësimin e mjedisit mundësuespër

¹⁵Pérez-SolórzanoBorrágán, Nieves. *Civil Society and EU Enlargement. In The Search for Europe. Contrasting Approaches*. Madrid: BBVA, 2015, gjendet në: <https://www.bbvaopenmind.com/en/articles/civil-society-and-eu-enlargement/>

¹⁶Ibid

¹⁷Faqja zyrtare e Komisionit Europian: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/policy-highlights/civil-society_en

¹⁸https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/ipa_ii_2018-040-646_2019-040-647_civil_society_facility_and_media_programme_2018-2019.pdf

një pjesëmarrje aktive dhe ngritje e fuqizim të kapaciteteve, ashtu dhe mbështetje e dialogut mes OSHC-ve dhe institucioneve publike në kuadër të integritetit evropian të vendit.

2. Procesi i integritetit në BE: Platforma e Partneritetit dhe Tryezat e Këshillimit

Procesi i bisedimeve për anëtarësimin në BE për Shqipërinë u miratuan nga vendimi i Këshillit i 25 marsit 2020: *“Këshilli, si subjekt vlerësimi nga anëtarët e Këshillit European vendosën të hapin negociatat e anëtarësimit për Republikën e Shqipërisë. Këshilli fton Komisionin që të sjellë propozimin e tij për kornizën negociuese. Konferenca e parë ndërqeveritare duhet të realizohet sa më shpejt pas miratimit të kornizës negociuese nga Këshilli.”*¹⁹ Vendimi i Këshillit, u shpjegua më së shumti si një vendim politik, ndërkohë që hapja reale e negociatave do të bëhej e mundur vetëm kur korniza negociuese e propozuar nga Komisioni të miratohej dhe ti hapej rruga zhvillimit të Konferencës së Parë Ndërqeveritare mes Shqipërisë dhe BE. Por që nga marsi i 2020, Këshilli e ka diskutuar këtë çështje dy herë të tjera dhe nuk ka arritur në një votim unanim për hapjen e negociatave. Sipas diskutimeve dhe deklaratave mes anëtarëve të Këshillit, Shqipëria duhet të përmbushë ende disa kriterë si: zbatimi i reformës zgjedhore, funksionimi i plotë i Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, fuqizimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këtë drejtim mund të thuhet që hapja teknike e negociatave nuk ka ndodhur ende, dhe ajo pritet që të realizohet gjatë 2021.

Mundësitë për hapjen e negociatave nënkuptojnë që Shqipëria të përgatitet për të ngritur strukturën e negociatave. Disa nga këto struktura në fakt janë ngritur më parë se vendimi i Këshillit i marsit 2020. Këto struktura filluan të krijoheshin që nga viti 2018, periudhë kur Komisioni European rekomandoi në mënyrë të pakushtëzuar për hapjen e negociatave me Shqipërinë.²⁰ Pas këtij rekomandimi që nuk u përkthye në një ‘po’ nga vendimi i Këshillit në qershor 2019, Komisioni European dhe Komisioneri i atëhershëm për Zgjerimin, Johannes Hahn propozuan fillimin e procesit *screening* për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, në mënyrë që të fitohej kohë dhe vendi të ishte i përgatitur në momentin që do të hapeshin zyrtarisht negociatat.

Procesi *screening* është puna përgatitore që bëhet për të vlerësuar dhe shqyrtuar harmonizimin e legjislacionit vendas me atë të BE. Ky proces normalisht fillon pas hapjes së bisedimeve, por për rastin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut me qëllim që këto vende mos të humbin

¹⁹Përfundimet e Këshillit mbi Procesin e Zgjerimit dhe Stabilizimit – Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Shqipërisë, 25 mars 2020: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

²⁰https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/albania_en

kohë, u vendos nga Komisioni që të fillonte para negociatave, duke u emëruar në këtë mënyrë si procesi *pre-screening*.

Faza e parë e këtij procesi përfshin: takimet shpjeguese për secilin kapitull të Acquis së BE. Për Shqipërinë janë përfunduar të gjitha këto takime, për 33 kapituj nga 35 që do të negociohen. Këto takime synojnë të bëjnë bashkë institucionet përgjegjëse të vendit kandidat si Ministrinë e Linjës apo dhe agjenci të tjera publike, me përfaqësues nga institucionet e BE për të diskutuar mbi kapitujt dhe çështjet me rëndësi të lidhura me to. Takimet e para shpjeguese Shqipëri-BE janë realizuar për Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, më 27-28 shtator 2018 dhe për Kapitullin 24: Drejtësia, Liria, Siguria realizuar më 12-15 nëntor 2018. Faza e dytë e procesit përfshin organizimin e takimeve dypalëshe për secilin kapitull, ku vendi kandidat prezanton nivelin e transpozimit të legjislacionit të tij me Acquis e BE, ndërkohë që paraqet dhe të gjitha strategjitë dhe planet e veprimit për progres të mëtijshëm për kapitullin në fjalë.

Në kuadër të këtyre zhvillimeve dhe ngjarjeve, u ngrit edhe struktura negociatore për Shqipërinë, miratuar në dhjetor 2018 në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 749, 19.12.2018 *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.”* Mbështetur në këtë vendim u miratuan dhe urdhrat e tjerë për ngritjen e organeve pjesë të strukturës negociatore si: Urdhri Nr. 94 i datës 20.05.2019 *“Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”* dhe Urdhri Nr. 93 i datës 20.05.2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës”*.

Sipas strukturës së miratuar, për secilin Kapitull të Acquis së BE janë ngritur nga një Grup Ndër Institucional i Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) përgjegjës për të analizuar gjendjen e politikave; legjislacionin; procedurat administrative; bashkëpunimin dhe partneritetin mes aktorëve që duhen përfshirë në secilin kapitull. GNPIE është organi përgjegjës për përgatitjen e Planit të Veprimit për Kapitullin dhe për përgatitjen e kushteve kuadër. Ndërkohë që Komiteti i grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian “ka si qëllim të drejtë, të vlerësojë, të monitorojë dhe të koordinojë realizimin e angazhimeve të GNPIE”²¹

Urdhri Nr. 113 i datës 30.08.2019 *“Për Format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”* shërben për ngritjen e një strukture shumë të rëndësishme për përfshirjen e të gjithë aktorëve në procesin e negociatave – Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian që synon pra angazhimin në mënyrë

²¹ Urdhri Nr. 93 i datës 20.05.2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës”*, neni 1

gjithëpërfshirëse të aktorëve të shoqërisë civile, sektorit privat, komunitetit akademik, partnerëve socialë, pushtetit vendor dhe aktorëve të tjerë të interesit. Me anë të Platformës ata do të kenë mundësi të informohen, të këshillojnë dhe të monitorojnë procesin e negociatave. Për të realizuar këtë proces përfshirjeje, për secilin kapitull që do të negociohet është ngritur apo po ngrihet një tryezë këshillimi. Këto tryeza që urdhri parashikon të ngrihen në mënyrë analoge me GNPIE-t do të drejtohen nga vetë kryetarët e GNPIE-ve dhe do të kenë në përbërje të tyre gjatë konsultimeve dhe bisedimeve aktorë të shoqërisë civile, biznesit apo autoriteteve publike, përfshirja e të cilëve do të bëhet e mundur nëpërmjet një aplikimi të thjeshtë e të shpejtë. Kështu, Neni III.2, pika 5 e Urdhrit parashikon se të interesuarit duhet të dërgojnë një letër interesi dhe një CV për të shfaqur interesimin e tyre mbi tryezat/kapitujt specifikë duke prezantuar eksperiencën dhe ekspertizën e tyre. Ata mund të aplikojnë si organizatë/institucion apo edhe individualisht.

Bazuar në këtë urdhër, çdo ministri hapi thirrjet për shprehje interesi për ato kapituj që ministrinë janë përgjegjëse për negociatat. Pjesa më e madhe e ministrive sipas të dhënave u mjaftuan me publikimin e kësaj thirrjeje në faqet e tyre zyrtare pa përdorur metoda të tjera për të informuar grupet që mund të ishin të interesuara. Kështu, që për disa ministri kjo qasje doli e pasuksesshme pasi numri i organizatave të informuara për këtë thirrje ishte i kufizuar dhe numri i aplikimeve ishte shumë i ulët. Ky ishte dhe rasti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që është përgjegjëse për negociatat për 13 kapituj. Ajo e ka publikuar në faqen zyrtare në tetor 2019 thirrjen për përfshirje në Platformë për një ose disa tryeza, por nuk pati asnjë të përzgjedhur, pasi dhe ato pak aplikime që erdhën nuk përshtateshin me fushat që mbulojnë kapitujt që MFE koordinon. Për këtë arsye, tryezat e këshillimit për të 13 kapitujt nuk janë ngritur ende, edhe pse më shumë se një vit ka kaluar që nga publikimi i thirrjes.²² Deri më tani vetëm Ministria e Drejtësisë ka realizuar një tryezë këshillimi në kuadër të Kapitullit 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelor dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ka realizuar gjithashtu një tryezë për Kapitullin 22: Kohezioni Rajonal dhe Fondet Strukturore.

Një arsye tjetër për mosesuksesin e ngritjes së shumicës së tryezave është dhe moment jo i përshtatshëm kur këto thirrje u publikuan. Në nëntor 2019 Shqipëria u prek nga një tërmet i fuqishëm me viktima dhe dëme të mëdha materiale. Për më tepër disa muaj më vonë në mars 2020, teksa e gjithë vëmendja ishte te masat për rimëkëmbje dhe ndërtimin, filluan masat e para kundër pandemisë Covid-19 që çoi në një mbyllje totale të vendit dhe veprimtarive ekonomike e shoqërore. Të dyja këto ngjarje madhore të ndodhura në një periudhë kohe shumë të afërt, detyruan strukturat dhe institucionet publike e jo vetëm, të orientonin të gjithë vëmendjen dhe

²² Ministria e Financave dhe Ekonomisë në Shqipëri: <http://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2019/10/Ministria-e-Financave-dhe-Ekonomise-6120-1.pdf>

aktivitetin e tyre në çështjet që lidheshin si më rindërtimin dhe zbutjen e pasojave të tërmetit, ashtu dhe menaxhimin e situatës pandemike.

Në rastin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka nisur puna për të rigjallëruar Tryezat e Këshillimit duke rishpallur edhe njëherë thirrjen për aplikime²³ duke përdorur tanimë disa metoda dhe strategji komunikimi dhe informimi, me qëllim njoftimin e sa më shumë personave dhe grupeve të interesit. Kështu në planin e ri të MFE metodat e shpërndarjes dhe informimit përfshijnë: kontaktet nëpërmjet adresave të e-mailit; fushatë në rrjetet sociale dhe publikimi në faqen zyrtare të Ministrisë, por edhe komunikimin e drejtpërdrejtë në sajë bashkëpunimesh dhe partneritetesh me aktorë kryesorë dhe organizata për tu përfshirë e për të ndarë më tej këtë mundësi me grupet dhe rrjetin e tyre.²⁴

Metodologjia e re e Zgjerimit e BE dhe hapja e negociatave

Më 5 shkurt 2020, Komisioni Europian prezantoi Metodologjinë e re të Zgjerimit, pasi nuk u arrit vendimi unanim pozitiv i Këshillit për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në vendimin e tetorit 2019, dhe pas një propozimi që Franca bëri për ristrukturimin dhe reformimin e procesit të zgjerimit të Bashkimit Europian.²⁵ Si pasojë e këtyre zhvillimeve Komisioni në metodologjinë e tij të re, propozoi që procesi i anëtarësimit të jetë më i besueshëm për të dyja palët. Një element tjetër i ri i propozuar është dhënia e një roli më përfshirës dhe aktiv të Këshillit, në mënyrë që të ketë mundësi të analizojë dhe vlerësojë të gjithë hapat e procesit. Në këtë mënyrë metodologjia e nxjerr më në pah elementin politik të procesit të anëtarësimit. Pra, u jepet mundësia Shteteve Anëtare, që janë njëkohësisht aktorët që votojnë në Këshill, të kenë rol më aktiv dhe të angazhohen gjatë gjithë procesit. Kjo përfshirje do të mundësojë më shumë hapësirë për dialog politik mes tyre dhe vendeve kandidatë, si dhe do të monitorojnë më nga afër dhe në mënyrë sistematike procesin. Kjo qasje politike, mund të ndihmojë që vendimmarrja e Këshillit të jetë realiste dhe objektive, pasi vet Shtetet Anëtare do të jenë më të qarta e më të mirëinformuara mbi progresin e reformave për secilin vend kandidat.

Një tjetër risi e metodologjisë është grupimi i 35 kapitujve të Acquis së BE në gjashtë grupime tematike të ndara: 1) **Themeloret** ku përfshihen tema si – mirëqeverisja, drejtësia dhe shteti i së drejtës; 2) **Tregu i brendshëm** që përfshin katër liritë e tregut dhe çështje të tjera financiare; 3) **Konkurrueshmëria** e lidhur me politikat social- ekonomike si punësimi, arsimi, kultura,

²³Thirrja është botuar në Qendrën e Botimeve Zyrtare: <https://qbz.gov.al/eli/bnjz/2021/7/a32df08f-fd4b-4032-baa6-6a35753006b7;q=Buletin%207>

²⁴Mund të gjeni më shumë këtu: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_20_182

²⁵Politico.eu, Propozimi i Francës: <https://www.politico.eu/wp-content/uploads/2019/11/Enlargement-nonpaper.pdf>

media dhe shkenca; 4) **Axhenda e Gjelbër** që përfshin kapitujt e energjisë, transportit, infrastrukturës dhe mjedisit; 5) **Burimet, bujqësia dhe kohezioni** ku futen kapitujt e bujqësisë, peshkimit, sigurisë ushqimore dhe politikave rajonale; 6) **Marrëdhëniet e jashtme**.

Grupimi tani do të hapet si i plotë, dhe jo në bazë të kapitujve individualë siç është proceduar me rastin e Serbisë e Malit të Zi. Në momentin që prioritetet e vendosura për grupimin (piketat hapëse) do të adresohen në mënyrë të suksesshme e të plotë, grupimi hapet pa kushte të tjera (pra të gjithë kapitujt që përfshihen në atë grup), ndërkohë që vendosen piketa mbyllëse për secilin kapitull.²⁶

Një element tjetër me rëndësi i prezantuar nga Metodologjia është edhe parimi i 'kthimit mbrapa'. Ky parim nënkupton që në vlerësimin që do i bëhet procesit në vazhdimësi, në sajë të progresit dhe zhvillimeve mund të ketë si shpërblime ashtu edhe 'ndëshkime'. Pra deri më tani ajo që ka ndodhur me vendet të cilat nuk e kanë shtyrë përpara procesin ka qenë ngadalësimi i tij, por me metodologjinë e re nëse vlerësohet që shteti nuk është i motivuar, nuk po punon dhe nuk po bën progres atëherë mund të ketë kthim të procesit që mund të përkthehet në kufizim apo heqje të asistencës si financiare ashtu dhe teknike, apo dhe mbyllje të kapitujve.

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut janë vendet e para ku procesi i negociatave do të bazohet në këtë metodologji, ndërkohë që është nënvizuar që për shtetet që janë duke negociuar kapitujt e Acquis me BE-në, si Serbia dhe Mali i Zi janë të lira ta miratojnë atë, por ndërkohë nuk do të preket korniza negociuese e tyre. Vetëm disa muaj pas prezantimit të metodologjisë, të dy vendet e pranuan Metodologjinë e Re. Mali i Zi e pranoi atë zyrtarisht në maj të 2020 me anë të një letre dërguar Komisionit Europian ku deklarohet që Mali i Zi mirëpret ato parime të metodologjisë së rishikuar që janë të përshtatshme me kornizën negociuese të vendit. Në korrik 2020, Serbia gjithashtu e pranoi Metodologjinë e Re dhe disa nga elementet e saj për ti përfshirë në procesin e vet negociues.

²⁶Komisioni Europian (2020), New Enlargement Methodology - Enhancing the accession process – A credible EU perspective for the Western Balkans: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/enlargement-methodology_en.pdf, fq. 4

3. Eksperiencia nga vendet e rajonit: Mësimet e nxjerra dhe praktikat më të mira

Rasti i Bullgarisë dhe Rumanisë: vendosja e kushteve pas anëtarësimit në BE

Këto dy vende karakterizohen nga një proces unik anëtarësimi në BE. Ato bëhen anëtare të BE-së në vitin 2007, edhe pse Traktatin e Anëtarësimit e firmosën që në 2006. Edhe pse kanë më shumë se 13 vite që janë pjesë e Bashkimit Europian, asnjë prej tyre nuk është bërë ende pjesë e zonës Shengen apo Eurozonës. Si arsye kryesore për këtë mospjesëmarrje shihet fakti që këto dy vende nuk kanë arritur ende standardet për një demokraci plotësisht funksionale, dhe akoma ekzistojnë problematika si korrupsioni apo krimi i organizuar. Kjo u bë shumë e qartë edhe nga vlerësimi i raportit të fundit të Vendeve në Tranzicion 2020, ku si Bullgaria dhe Rumania vlerësohen si vende më demokraci gjysmë të konsoliduar.²⁷

Një element i veçantë i prezantuar gjatë nënshkrimit të Traktatit të Anëtarësimit, ishte Mekanizmi i Verifikimit dhe Bashkëpunimit (CVM) i krijuar me objektivin e vetëm që këto vende të vazhdonin me reformat edhe pas futjes në BE, duke qenë që deri atëherë standardet e kërkuara nuk ishin arritur plotësisht. Pra, mund të thuhet që CVM po luante për Bullgarinë dhe Rumaninë, rolin që sot luan procesi i para-anëtarësimit për Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Ai u vendos për të shërbyer si një mekanizëm tranzitor për të ndihmuar këto vende të arrinin standardet që duhet të plotësojë një Shtet Anëtar i BE.

Por BE-së i duhej që të ruante një presion të qëndrueshëm në mënyrë që qeveritë e dy vendeve të vazhdonin me reformat. Për këtë Komisioni Europian në mënyrë periodike ka publikuar një raport progresi të Bullgarisë dhe Rumanisë nën CVM. Ato përfshijnë një vlerësim dhe shqyrtim të detajuar të kritereve që duhen plotësuar nga secili vend dhe përfshijnë gjithashtu edhe rekomandime për më tej. Raporti i parë i CVM është publikuar më 27 qershor 2007, dhe secili raport pas prezantimit nga Komisioni Europian duhet të miratohet nga Këshilli.

Edhe pse shtete anëtare të BE-së, Bullgaria dhe Rumania kanë detyra shtëpie që duhet ti përmbushin, njëjtë si vendet kandidate të Ballkanit Perëndimor. Ndryshimi është që për Bullgarinë dhe Rumaninë këto kushte u vendosën pas anëtarësimit, ndërkohë që vendet kandidate të Ballkanit Perëndimor duhet të punojnë për ti realizuar ato gjatë procesit të para

²⁷Freedom House, Vende në Tranzicion 2020 . Në raportin e 2020 Bullgaria është vlerësuar me 59 nga 100, ndërsa Rumania me 57 nga 100; të dyja të vlerësuara kështu si demokraci gjysmë të konsoliduara. Më shumë gjeni në: <https://freedomhouse.org/countries/nations-transit/scores>

anëtarësimit. Kështu për Bullgarinë janë 6 piketa që duhen përmbushur dhe për Rumaninë janë 4, fokusuar në çështje që lidhen me reformën në drejtësi – efienca, përgjegjshmëria, integriteti i sistemit; parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit/krimin të organizuar, të njëjta me ato çështje që janë konsideruar themelore për progresin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në procesin e negociatave. CVM parashikohej të përfundonte rolin e tij në momentin që të gjitha piketat do të realizoheshin plotësisht. 10 vite pas publikimit të raportit të parë të CVM, Komisioni në 2017 ndryshoi metodologjinë e realizimit dhe vlerësimit të progresit duke ofruar rekomandime konkrete për të dyja vendet. Dhe që atëherë ai ka vlerësuar progresin e vendeve për përmbushjen e këtyre rekomandimeve, raporti i nëntorit 2017 dhe i nëntorit 2018.²⁸

Me rëndësi për tu nënvizuar është që Bullgaria dhe Rumania janë të vetmet vende të BE-së për të cilët është vendosur një mekanizëm i tillë pas anëtarësimit. Ndërkohë që vetëm disa vite pas anëtarësimit të tyre, Kroacia po përmbyllte procesin e negociatave me BE, dhe gjithmonë e më shumë po diskutohej që një mekanizëm i tillë të vendosej dhe për Kroacinë. Por CVM nuk ka pasur efektin dhe ndikimin që pritej. Pavarësisht faktit që qeveritë synonin ta hiqnin këtë mekanizëm sa më parë, motivimi për të përmbushur të gjitha kriteret nuk ka qenë në të njëjtin nivel. Për këtë, kur u vu re që motivimi për reforma pas anëtarësimit bie ndjeshëm, pasi vendi e ka arritur objektivin për tu bërë pjesë e BE-së, progresi nën CVM u lidh me progresin që vendet do të mund të bënin kah Eurozona apo Shengeni.²⁹ Kështu, BE vendosi kushtin që vetëm nëse vendet plotësonin kushtet e vendosura nga CVM, ato mund të fillonin të kishin progres edhe në anëtarësimin në Eurozonë apo Shengen. Kjo ishte dhe një nga arsyt pse u hoq dorë nga mendimi për të përfshirë dhe Kroacinë nën një mekanizëm të tillë. E parë si një gabim i vendosur nga BE, në Strategjinë e Zgjerimit për vitin 2010 Bashkimi Europian shprehet se *“negociatat me Kroacinë do të përmbillen vetëm kur Kroacia të ketë plotësuar të gjitha piketat përmbjllëse, sidomos ato në fushën e sistemit gjyqësor dhe të drejtave të njeriut, dukë përfshirë dhe luftën kundër korrupsionit. Në këtë mënyrë ikën nevoja e BE-së për të konsideruar vendosjen e një mekanizmi bashkëpunimi dhe verifikimi pas anëtarësimit”*.³⁰

Ishte planifikuar që viti 2019 të ishte viti i fundit i funksionimit të CVM, por përkeqësimi i situatës në Bullgari dhe Rumani lidhur më çështjet e demokracisë dhe drejtësisë detyruan Komisionin të nxirrte rekomandime të tjera edhe për atë vit. CVM gjithsesi nuk do funksionojë më, e kjo jo sepse Rumania dhe Bullgaria kanë përmbushur me sukses detyrimet e tyre. Arsyeja qëndron në vet ndryshimin e metodologjisë së Komisionit dhe rasteve problematike të përkeqësimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, që po shfaqen dhe në vende të tjera të

²⁸Faqja zyrtare e Komisionit Europian: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ganda_19_6137

²⁹ Bechev, D., Bulgaria and Romania's EU accession: Lessons Learned, August 2020: <http://em-al.org/sq/anetaresimi-i-bullgarise-dhe-rumanise-ne-bashkimin-europian-mesimet-e-nxjerra-dr-dimitar-bechev/>

³⁰ Komunikatë e Komisionerit të atëhershëm për Zgjerimin, Stefan Fule, mbi Strategjinë e Zgjerimit të BE 2010: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/SPEECH_10_639

BE-së si në Hungari apo Poloni. Për këtë Komisioni European ka prezantuar Vlerësuesin e Drejtësisë (Justice Scoreboard) ³¹ për të gjithë vendet e BE, duke i dhënë mundësi Komisionit të monitorojë të gjithë shtetet në çështje që lidhen me drejtësinë, të drejtat e njeriut dhe korrupsionin.

Rasti i Kroacisë: procesi i integrimit që u karakterizua nga mospërfshirja e shoqërisë civile

Anëtarësimi i Kroacisë në BE është vlerësuar si një histori suksesi, nga e cila vendet e tjera të Ballkanit duhet të kishin marrë shënime. Brenda 10 viteve Kroacia arriti të kalonte të gjitha fazat e procesit të integrimit dhe më 1 korrik 2013 ajo u bë anëtarja e 28 e Bashkimit European. Negociatat u hapën dhe u mbyllën brenda gjashtë viteve, nga 2005 në 2011, në të njëjtin vit Kroacia nënshkroi Traktatin e Anëtarësimit. Referendumi për futjen në BE u mbajt më 22 janar 2012, ku 66.27% e qytetarëve kroatë mbështetën futjen e Kroacisë në BE, ndërkohë që parlamenti kroat ratifikoi unanimitisht Traktatin e Anëtarësimit më 9 mars 2012.³² Sa i përket procesit të negociatave, Korniza e Negociatave e miratuar në mars 2005 nga Këshilli, solli disa risi në krahasim me proceset e kaluara. Elementi më thelbësor i prezantuar ishte mekanizmi kushtëzues i njohur si piketat hapëse dhe mbyllëse (opening/closing benchmarks), që nuk janë gjë tjetër veçse detyra dhe kritere që duhen përmbushur për të hapur e për të mbyllur secilin kapitull të Acquis së BE.³³

Pavarësisht këtyre risive procesi i integrimit dhe më konkretisht ai i negociatave është cilësuar si jo transparent, ku aktorët e shoqërisë civile por edhe aktorët e tjerë jo-shtetërorë u përfshinë në mënyrë shumë sipërfaqësore dhe të kufizuar. Kështu, parimi i transparencës dhe konfidencialitetit gjatë bisedimeve dhe shpërndarjes së informacionit mes Kroacisë dhe BE-së nuk ishin përfshirë në Kornizën e Negociatave.³⁴ Kjo e bëri të paqartë rolin dhe pozicionin që shoqëria civile dhe aktorët e tjerë jo-shtetërorë do të kishin në proces.

Përfshirja e shoqërisë civile u bë e mundur vetëm nëpërmjet strukturës së negociatave miratuar nga qeveria kroate. Një nga organet e ngritur, së bashku me Kryenegociatorin dhe Grupin Negociator të përbërë prej 13 personash, ishin edhe Grupet e Punës për Përgatitjen e Negociatave për çdo kapitull të Acquis. Në këto grupe është llogaritur që janë përfshirë rreth

³¹ Gjenerali më shumë në: https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/upholding-rule-law/eu-justice-scoreboard_en

³² Faqja zyrtare e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Kroaci: <http://www.mvep.hr/en/croatia-and-the-european-union/negotiation-process/>

³³ Transparency in retrospect: preliminary lessons from Croatia's EU accession process Discussion paper Commissioned by the Greens / EFA in the European Parliament Prepared by Marina Škrabalo, GONG Research Centre, Croatia, fq. 2, <https://www.franziska-brantner.eu/wp-content/uploads/2012/11/Transparency-in-retrospect.pdf>

³⁴ Ibid, fq. 2

1 800 ekspertë. Çdo Grup Pune (35 gjithsej) kishte rreth 30 – 50 anëtarë. Gjithsesi shumica e anëtarëve vinin nga administrata publike dhe vetëm një pjesë, rreth 1/3 ishin përfaqësues nga OSHC, biznesi dhe komuniteti akademik. Siç është përmendur dhe në urdhrin për këtë strukturë Grupet e Punës do të ishin aktive në procesin screening dhe në përgatitjen e propozimeve për pozicionet negociuese, në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe aktorë të tjerë të përfshirë.³⁵ Por, problematike nuk ishte vetëm numri i kufizuar i aktorëve jo-shtetërorë por edhe fakti që anëtarët e këtyre grupeve nuk e kishin aspak të qartë se cilat ishin roli, përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre në këtë proces, pasi nuk u ishte ofruar asnjë udhëzim apo dokument sqarues mbi rolin dhe angazhimin e tyre. Gjatë procesit janë vërejtur raste ku Grupet e Punës kanë marrë pjesë vetëm në procesin screening dhe më pas nuk janë përfshirë në fazat e tjera si ajo e hartimit të pozicioneve negociuese.

Për më tepër në disa sondazhe të kohës të cilat analizonin gjendjen e OSHC-ve në Kroaci, në 2009 katër vite pas hapjes së negociatave, rreth 44% e përfaqësuesve nga OSHC janë shprehur se ato nuk janë përfshirë në procesin e negociatave e nuk e kanë ndjekur atë. Si arsye kryesore është fakti që as nuk janë ftuar, dhe as nuk janë informuar për tu bërë pjesë e grupeve të punës dhe procesit konsultues. Arsye të tjera lidhen dhe me problematikat e vet OSHC-ve kroate në atë periudhë si mungesa e ekspertizës dhe kapaciteteve mbi procesin e integritetit evropian dhe mbi vet BE-në.³⁶

E vlerësuar negativisht nuk është vetëm mungesa e përfshirjes së shoqërisë civile, por edhe mënyra e komunikimit me qytetarët në tërësi dhe sesi u zbatuan strategjitë e komunikimit gjatë këtij procesi. Kështu, dokumentet kryesore të procesit të negociatave nuk ishin publike dhe nuk mund të gjendeshin të publikuara, ndërkohë që dhe hapësirat për dialog dhe komunikim me qytetarët ishin shumë të kufizuara. Përfundimi ka dalë, që pjesa më e madhe e popullsisë nuk kishte informacion mbi BE-në, sipas sondazheve rreth 87% e qytetarëve janë shprehur se e konsiderojnë veten të painformuar plotësisht për procesin e anëtarësimit³⁷, duke ndikuar në pamundësinë e tyre për të pasur një qëndrim objektiv dhe kritik ndaj anëtarësimit të vendit në BE ku mungonte analiza e kosto-përfitimeve. Një opinion publik i painformuar, është parë dhe si faktori kryesor përse mbështetja ndaj futjes në BE ka rënë nga viti në vit gjatë procesit të integritetit të Kroacisë³⁸, si dhe pse numri i qytetarëve që morën pjesë në referendum ishte i

³⁵Faqja zyrtare e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Kroaci: <http://www.mvep.hr/en/croatia-and-the-european-union/negotiation-process/negotiation-structure/working-groups/>

³⁶Šeperić, Darko. "To Europe and Back – The Croatian EU Accession Process and Its Outcomes." SEER: Journal for Labour and Social Affairs in Eastern Europe, vol. 14, no. 4, 2011, pp. 463–480. JSTOR, www.jstor.org/stable/43293436

³⁷Transparency in retrospect: preliminary lessons from Croatia's EU accession process Discussion paper Commissioned by the Greens / EFA in the European Parliament Prepared by Marina Škrabalo, GONG Research Centre, Croatia, <https://www.franziska-brantner.eu/wp-content/uploads/2012/11/Transparency-in-retrospect.pdf>

³⁸Šeperić, Darko. "To Europe and Back – The Croatian EU Accession Process and Its Outcomes." SEER: Journal for Labour and Social Affairs in Eastern Europe, vol. 14, no. 4, 2011, pp. 463–480. JSTOR, www.jstor.org/stable/43293436

ulët. Edhe pse kjo votë kishte një rëndësi mjaft të madhe pasi përcaktonte fatin e vendit, më pak se gjysma e popullsisë, diçka të 43.5% votuan në referendum.

Si përfundim mund të theksohet që procesi i negociatave i Kroacisë mbeti një 'projekt elitist'³⁹, ku përveç institucioneve shtetërore, pjesa tjetër e shoqërisë mbeti jashtë, nuk u përfshi për të qenë një aktor aktiv dhe nuk u informua mbi pasojat dhe perspektivat e këtij vendimi. Duke mos përfshirë shoqërinë civile Kroacia në fakt nuk arriti të përmbushte objektivat e strategjisë së Bashkimit European mbi rolin dhe promovimin e shoqërisë civile që janë: monitorimi i procesit dhe informimi i qytetarëve, në mënyrë që në fund vendimi të ketë miratimin e konsensusin e të gjithë shoqërisë. Autorë e ekspertë janë shprehur që për Kroacinë në këtë proces prioritar ishte shpejtësia e tij se sa transparenca dhe gjithëpërfshirja.⁴⁰

Rasti i Serbisë: si vend që ka hapur negociatat me BE-në

Bisedimet për anëtarësim mes BE dhe Serbisë janë hapur zyrtarisht në 2014, në momentin që u zhvillua Konferenca e Partë Ndërqeveritare në Bruksel. Kjo konferencë u organizua pas vendimit pozitiv të 25 qershorit 2013 të Këshillit për hapjen e negociatave me Serbinë. Konferenca shërben si një takim vjetor periodik ku përfaqësues nga institucionet e BE dhe Serbisë shkëmbejnë pikëpamje dhe ide mbi procesin reformues dhe europeanizues të vendit. Në Konferencën e parë që mbahet, si dhe në rastin serb prezantohet Korniza Negociatore e BE-së dhe qëndrimi i saj mbi negociatat e anëtarësimit. Në këtë drejtim mund të thuhet që Konferenca e parë ka më shumë një format politik, ku përfaqësues të lartë nga të dyja palët marrin pjesë.

Kështu në Konferencën e Parë Ndërqeveritare mes Serbisë dhe BE-së, morën pjesë kryeministri dhe ministri i punëve të jashtme dhe ai i integritetit european serb nga pala serbe. Ndërkohë që BE kishte përfaqësues nga Komisioni European, Këshilli dhe disa Shtete Anëtare. Konferencat e mëtejshme të mbajtura çdo vit, kanë pasur më shumë një format teknik ku diskutimi është fokusuar në progresin e kapitujve të ndryshëm. Gjithashtu Konferencat kanë shërbyer dhe për hapjen zyrtare të kapitujve. Deri më tani Serbia ka organizuar 11 Konferenca Ndërqeveritare,

³⁹Transparency in retrospect: preliminary lessons from Croatia's EU accession proces Discussion paper Commissioned by the Greens / EFA in the European Parliament Prepared by Marina Škrabalo, GONG Research Centre, Croatia, <https://www.franziska-brantner.eu/wp-content/uploads/2012/11/Transparency-in-retrospect.pdf>

⁴⁰Šeperić, Darko. "To Europe and Back – The Croatian EU Accession Process and Its Outcomes." SEER: Journal for Labour and Social Affairs in Eastern Europe, vol. 14, no. 4, 2011, pp. 463–480. JSTOR, www.jstor.org/stable/43293436

ku gjatë secilës prej tyre ka hapur një ose disa kapituj, ku numërohen 18 kapituj të hapur në total, ndërkohë që 2 prej tyre janë përkohësisht të mbyllur. Në Konferencën e mbajtur të fundit më 10 dhjetor 2019 Serbia hapi kapitullin 4 – Lëvizja e Lirë e Kapitalit. Ndërkohë që Konferenca për vitin 2020 nuk u organizua, kjo si pasojë dhe e situatës së Covid-19.

Gjatë hapjes së negociatave dhe organizimit të Konferencës së Partë Ndërqeveritare vëmendja u vendos edhe të roli që duhet të ketë shoqëria civile. Në fakt përfshirja e shoqërisë civile në procesin e negociatave është përmendur edhe në Kornizën Negociuese të BE-së për Serbinë⁴¹, në mënyrë që të jenë palë të përfshira në monitorim dhe konsultim, por edhe për të shmangur rastin kroat.⁴² Por në fakt, qeveria serbe planifikonte të mbështeste një model ku OSHC-të të mos përfshiheshin zyrtarisht dhe në mënyrë direkte në bisedimet për anëtarësim, por të luanin më shumë rolin e një ‘rojtari’. Pra të monitoronin dhe mbikëqyrnin procesin pa u përfshirë në të. Për këtë, struktura e negociatave e Serbisë dhe aktorët që do të përfshiheshin aty nuk ishin qartësuar dhe ndërkohë elementi i transparencës mungonte, duke shtyrë shoqërinë civile në Serbi të vet-organizohej në mënyrë që jo vetëm ta monitoronte, por edhe ta influenconte procesin e negociatave.

Si pasojë e kësaj, u ngrit Konventa Kombëtare mbi Bashkimin European në Serbi, një iniciativë e nxitur nga vetë organizatat, e cila mbulon të 35 kapitujt e Acquis së BE. Platforma bazohet në eksperiencën sllovaqe, dhe është mbështetur financiarisht por edhe teknikisht në fillesat e saj nga partnerët sllovakë. Qëllimi kryesor i Konventës është të bëj bashkë aktorë të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, të diskutojnë dhe bashkëpunojnë në bërjen e politikave, procesit të reformave dhe marrjes së vendimeve në kuadër të integritimit european. Konventa në Serbi ka në përbërje të saj një rrjet prej 750 organizatash të shoqërisë civile dhe ka ngritur 21 grupe pune që kanë në fokus një ose më shumë kapituj të Acquis së BE.

Një sukses i Konventës ishte njohja zyrtare nga qeveria serbe, në gusht 2018 që kjo do të ishte platforma që do të shërbente për informimin dhe konsultimin e procesit të negociatave.⁴³ Konventa ka arritur qëllimin e saj për të pasur një proces sa më gjithëpërfshirës, transparent

⁴¹Civil Society in the EU Integration of the Western Balkans,

<https://www.files.ethz.ch/isn/184325/Civil%20Society%20in%20the%20EU%20Integration%20of%20the%20Western%20Balkans.pdf>

⁴²Transparency in retrospect: preliminary lessons from Croatia's EU accession proces Discussion paper

Commissioned by the Greens / EFA in the European Parliament Prepared by Marina Škrabalo, GONG Research Centre, Croatia,

<https://www.franziska-brantner.eu/wp-content/uploads/2012/11/Transparency-in-retrospect.pdf>

⁴³Faqja zyrtare e Konventës Kombëtare për Integrimin European në Serbi: <https://eukonvent.org/>

dhe që ka fuqizuar bashkëpunimin dhe dialogun mes aktorëve shtetërorë dhe shoqërisë civile. Platforma siç është shpjeguar në faqen e saj zyrtare online ofron⁴⁴:

- 1) **Konsultime periodike midis organeve shtetërore dhe grupeve të interesit dhe publikut në lidhje me fazat e ndryshme të negociatave;**
- 2) **Realizimin e rekomandimeve dhe opinioneve** sa i përket pozicionit të Serbisë gjatë bisedimeve, si dhe monitorim të përmbushjes së piketave dhe kushteve në kapitujt që po negociohen;
- 3) **Ofrimi i një dialogu të hapur dhe transparent** gjatë gjithë procesit të negociatave
- 4) **Cilësi e lartë informimi të publikut** në lidhje me anëtarësimin, negociatat dhe pasojat e efektet e këtij procesi

Grupet e Punës që janë ngritur nga Konventa kanë të njëjtën strukturë si grupet negociatore që janë ngritur nga vet qeveria. Secili grup udhëhiqet nga një OSHC ose një koalicion organizatash bazuar në ekspertizën dhe eksperiencën e tyre. Grupet janë të hapura për çdo organizatë apo individë që janë të interesuar të përfshihen dhe të kontribuojnë. Çdo grup Punë përbëhet nga 25-30 ekspertë, përfaqësues të Organizatave Jo-Fitimprurëse, shoqatave, organizatave profesionale, strukturave të vet-qeverisjes lokale, media dhe grupeve të tjera të interesuar në çështje që përfshihen në kapitujt përkatës.

Rasti i Maqedonisë së Veriut: si vendi në të njëjtën fazë me Shqipërinë

Këshilli vendosi për hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut në të njëjtën ditë si dhe për Shqipërinë, pra në vendimin e 25 marsit 2020. Por rasti i Maqedonisë së Veriut ndryshon shumë nga ai i Shqipërisë, edhe pse sot ato gjenden në të njëjtën fazë dhe presin të dyja organizimin e Konferencës së Parë Ndërqeveritare. Maqedonia e Veriut duhet të priste 15 vite për të hapur negociatat me BE-në pas marrjes së statusit kandidat, ndryshe nga Shqipëria që këtë status arriti ta merrte vetëm në 2014. Bisedimet për anëtarësim për Maqedoninë e Veriut do të realizohen në kuadër të Metodologjisë së re të zgjerimit të BE, ashtu si dhe për Shqipërinë e priten të jenë vendet e para që do të hapin negociatat nën këtë metodologji. Kjo do të thotë që të dyja vendet edhe pse nuk kishin të njëjtin start tani po ndjekin të njëjtën rrugë dhe kanë arritur në një pikë ku do të mund të krahasojnë progresin e njëra-tjetrës; pavarësisht, kjo nuk do të thotë që ato do të kenë të njëjtën shpejtësi e të njëjta shpërblime dhe përfundime.

⁴⁴Ibid

Sa i përket shoqërisë civile në MV ajo është cilësuar si një aktor i rëndësishëm i procesit vendimmarrës dhe reformues. Për herë të parë shoqëria civile është përmendur si aktor me rëndësi në një rezolutë të Parlamentit mbi prioritetet e vendit në kuadër të integritetit në BE. Sipas kësaj rezolute OSHC-të duhet të përfshihen në proces ndërkohë që qeveria duhet të marrë masa për ta lehtësuar këtë përfshirje.⁴⁵ Ngjashëm me rastin shqiptar, në Maqedoninë e Veriut është krijuar Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian ku aktorë të shoqërisë civile janë pjesë e këshillit dhe mblidhen e kontribuojnë në procesin e negociatave me BE. I themeluar më 19 nëntor 2007, Këshilli është e vetmja strukturë në vend ku bëhen bashkë përfaqësues të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv me aktorët jo-shtetërorë.⁴⁶ Objektivi kryesor i Këshillit është mbështetja e vendit në kuadër të anëtarësimit në BE; të fuqizojë dialogun mes palësh dhe të ndihmojë në arritjen e konsensusit politik gjatë vendimmarrjes.

Ndërkohë struktura të tjera, janë ngritur ku aktorë të shoqërisë civile apo edhe të grupeve të tjera kanë mundësi të përfshihen në procesin konsultativ apo politikëbërës siç janë: Këshilli për Bashkëpunim dhe Zhvillim i Shoqërisë Civile; Këshilli për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë së Reformës në Drejtësi; Këshilli për Kontrollin Civil për Shërbimet e Sigurisë si dhe krijimi i grupeve të punës në ministri të ndryshme dhe në grupet sektorale të IPA.⁴⁷ Shoqëria civile luan një rol aktiv dhe angazhues, dhe konsiderohet një aktor kyç në procesin e vendimmarrjes në vend.

Ky rol është fuqizuar edhe nga zbatimi i Strategjisë dhe Planit të tij të Veprimit për Bashkëpunim mes Qeverisë dhe Shoqërisë civile 2018-2020. Vlerësim pozitiv vjen dhe nga raporti i Komisionit për vitin 2020: *“Mjedisi ku shoqëria civile operon ka vazhduar të përmirësohet. Shoqëria civile ka vazhduar të jetë aktive dhe të luajë një rol të rëndësishëm në procesin politikëbërës dhe vendimmarrës. Gjithsesi duhen më shumë përpjekje për të arritur një proces të plotë konsultimi. Ndërkohë që kuadri ligjor dhe ai financiar duhet të vazhdojnë të përmirësohen dhe të zbatohen plotësisht. Që nga miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2018-2020 progres i mirë është bërë sa i përket funksionit dhe punës së Këshillit për Bashkëpunim mes Qeverisë dhe Shoqërisë Civile. Takimet mes anëtarëve të këtij Këshilli janë bërë më të shpeshta. Përfshirja e shoqërisë civile në proceset e politikbërjes dhe vendimmarrjes është përmirësuar pas miratimit të Strategjisë në fjalë. Duhet të vazhdojnë përpjekje të mëtejshme për të siguruar një proces të plotë dhe brenda afateve kohore.”*⁴⁸

⁴⁵Faqja zyrtare e Parlamentit në Maqedoninë e Veriut: <https://www.sobranie.mk/kuvendi-i-republik-s-s-magedonis-dhe-parlamenti-evropian.nspx>

⁴⁶Ibid

⁴⁷Nikolovski, I., Civil society organisations and North Macedonia's European integration: Towards strategic participation and transparent accession negotiations, pg. 4, Advocacy Paper No.32/2020, KAS in North Macedonia

⁴⁸Raporti i Komisionit Europian 2020 për Maqedoninë e Veriut, fq.11-12: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf

Struktura e negociatave për Maqedoninë e Veriut u miratua më 1 gusht 2019 nga shtatë vendime të miratuara, dhe vihet re që ajo do të jetë e ngjashme me strukturën e negociatave që ka për momentin Mali i Zi. Kështu kjo strukturë përfshin: Komitetin e Punës për Integrimin Europian; Komitetin për Negociatat; Delegacionin e Shtetit për Negociata; Grupin Negociator; Zyrën e Kryenegociatorit Teknik; Grupet e Punës për përgatitjen e Programit Kombëtar për Miratimin e Acquis dhe zhvillimin e hartimin e qëndrimeve negociatore për anëtarësimin në BE.⁴⁹ Siç është përmendur dhe në këto vendime, Grupet e Punës për përgatitjen e Programit Kombëtar do të përfshijnë përfaqësues si nga autoritetet shtetërore, ashtu dhe nga shoqëria civile, akademia, qeverisja lokale, biznesi dhe grupe të tjera interesi.⁵⁰ Pavarësisht kësaj, sipas ekspertëve dhe përfaqësuesve të ndryshëm të shoqërisë civile është vlerësuar që procedura e anëtarësimit në këto grupe dhe e përfshirjes është e paqartë dhe nuk ka informacion se si anëtarët në këto grupe do të përzgjidhen.

Përditësimi i procedurës është tashmë një temë që po diskutohet në rrethet e komunitetit të shoqërisë civile në Maqedoninë e Veriut. Ata kërkojnë ndryshime të strukturës dhe procedurës bazuar në dy arsye kryesore: *së pari*, për shkak të publikimit të metodologjisë së re të zgjerimit ku u prezantuan elemente të reja që do të duhet të përfshihen dhe nga struktura e vendit për negociatat, dhe *së dyti*, duhet të qartësohet procedura dhe kriteret e aplikimit dhe përzgjedhjes së aktorëve të shoqërisë civile për përfshirjen e tyre, pasi deri më tani nuk ka asnjë dokument zyrtar ku shpjegohet në detaje struktura e negociatave dhe roli i aktorëve jo-shtetërorë.⁵¹ Një grup organizatash të shoqërisë civile prezantuan publikisht qëndrimet e tyre ndaj strukturës duke ofruar dhe sugjerime për përmirësimin e saj.⁵² Një nga rekomandimet lidhej dhe me përfshirjen e parlamentit në proces për të luajtur rolin e tij mbikëqyrës dhe kontrollues, për të shmangur monopolizimin e procesit vetëm nga një palë. Kjo kërkesë specifike vjen, pasi kuvendi dhe roli i tij nuk janë përmendur aspak në dokumentet zyrtare të negociatave të publikuara deri më tani.

Si përfundim, megjithëse shoqëria civile në MV ka aktualisht një rol aktiv dhe angazhohet në proceset e konsultimit dhe përfshihet në disa struktura, kur bëhet fjalë për strukturën negociatore vihet re se angazhimi i tyre konkret dhe mënyra e përfshirjes është ende e paqartë dhe e pavendosur. Transparenca nga ana e qeverisë për të publikuar procedurat e informacionin mbi strukturën negociatore dhe mënyrat e përfshirjes, është thelbësore ku të

⁴⁹Nikolovski, I., Civil society organisations and North Macedonia's European integration: Towards strategic participation and transparent accession negotiations, pg. 4, Advocacy Paper No.32/2020, KAS in North Macedonia

⁵⁰Ibid, pg. 4

⁵¹ Positions of civil society organizations: A model of negotiations with the EU tailored to society as a whole, North Macedonia: <https://idscs.org.mk/mk/2018/12/13/7559/>

⁵² Ibid

dhëna si personat përgjegjës, kontaktet, fushat dhe përgjegjësitë specifike të sqarohen. Transparenca dhe komunikimi janë kyç dhe për informimin e qytetarëve dhe opinionit publik mbi të gjithë zhvillimet e procesit të negociatave dhe të anëtarësimit. Që ky proces të vlerësohet si gjithëpërfshirës Parlamenti duhet gjithashtu të përfshihet dhe të marrë pjesë në mënyrë aktive në çdo fazë që vendi po kalon në kuadër të integrimit europian.

4. Përfundime

Sa më sipër mund të dalim në përfundimin se procesi i integrimit në BE, nuk është një proces linear dhe i njëjtë për të gjithë vendet. Në çdo proces të zhvilluar janë shtuar elemente të reja, për ta bërë atë më të besueshëm por edhe më të sigurt në arritjen e qëllimeve me sukses dhe në mënyrë të plotë. Eksperienca për çdo shtet i ka shërbyer BE-së për të nxjerrë mësimet e për ta përmirësuar atë për vendet e tjera, ndërkohë që këto eksperiencë shërbejnë si leksione edhe për vendet që po punojnë për anëtarësimin në Bashkimin Europian.

Modelet e marra në konsideratë tregojnë dinamikën e shumta, aktorët dhe faktorët e shumtë që ndikojnë në progresin e tij që shpeshherë ndikojnë në shpejtimin e procesit e herë të tjera e ngadalësojnë dhe e pengojnë atë. Por procesi i anëtarësimit në BE nuk duhet parë vetëm në raport me Bashkimin Europian dhe shtetit kandidat, por më shumë rendësi është dhe bashkëpunimi dhe raporti mes aktorëve të brendshëm të vet vendit. Dhe pse qëllimi kryesor i të gjithë sektorëve të shoqërisë është integrimi në BE, interesat e tyre jo gjithmonë përputhen. Për këtë është thelbësore përfshirja e tyre në proces, në mënyrë që pikësëpari të informohen për të gjitha kosto-përfitimet dhe së dyti për tu angazhuar në ofrimin e sugjerimeve dhe rekomandimeve gjatë bisedimeve për anëtarësim.

5. Rekomandime:

Për institucionet shtetërore:

- I gjithë procesi duhet të karakterizohet nga transparenca dhe ofrimi i informacionit të hapur te publiku sa i përket dokumenteve dhe publikimeve me rëndësi për procesin *screening* dhe atë të negociatave për secilin kapitull. Vetëm nëse realizohet kjo, procesi si i tërë mund të monitorohet nga aktorët e tjerë si shoqëria civile, ndërkohë që qytetarët do të jenë të informuar mbi atë çfarë po negociohet dhe mbi të gjitha për kosto-përfitimet e çdo vendimi të ndërmarrë.
- Janë të nevojshme vendosja dhe përcaktimi i rregullave apo procedurave të qarta e të mirëpërcaktuara sesi aktorët jo-shtetërorë mund të përfshihen për të kontribuar në procesin e negociatave si shoqëria civile, akademia apo komuniteti i biznesit. Kuadri ligjor është miratuar, ai parashikon krijimin e Platformës së Partneritetit dhe ngritjen e Tryezave të Diskutimit dhe Këshillimit, por ndërkohë jo të gjitha këto tryeza janë ngritur dhe janë funksionale. Mbetet me rëndësi që aktorët që do të përfshihen në këto tryeza të jenë të qartë mbi rolin dhe angazhimin që pritët prej tyre dhe mundësive për kontribute në kuadër të platformës së partneritetit.
- Procesi i konsultimit gjatë vendimmarrjes në kuadër të integritetit europian dhe reformimit të vendit duhet të konsiderohet si prioritet, pasi kjo bën të mundur që procesi i integritetit europian të jetë gjithëpërfshirës dhe transparent, ku të gjithë aktorët e shoqërisë janë të mirëinformuar dhe kanë hapësirat e duhura për përfshirje.
- Trupat këshillues të ngritur si Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile apo Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian duhet të forcohen dhe të jenë sa më përfshirës. Gjithëpërfshirja dhe forcimi i rolit të tyre këshillimor dhe monitorues, do të kontribuojë në nxitjen e konsensusit politik ndërkohë që kuadri ligjor dhe institucional rishikohet e përmirësohet në vazhdimësi.
- Një strategji komunikimi duhet hartuar dhe miratuar mbi integritetin europian, me fokus shoqërinë civile dhe qytetarët, në mënyrë që të krijohet një hapësirë dialogu publike ku të gjithë palët informohen mbi procesin dhe pasojat e implikimet e tij. Vetëm nëse qytetarët kanë informacionin e nevojshëm për të, ata mund të mendojnë dhe në mënyrë kritike për procesin si dhe të marrin vendime të mirëformuara.
- Eksperiencat dhe rastet e shteteve që tashmë janë në BE po që kanë pasur një kontekst të ngjashëm me vendin tonë si Bullgaria, Rumania dhe Kroacia duhet të shërbejnë si shembuj ku vendi dhe autoritetet shtetërore mund të nxjerrin leksione.

- Përfshirja e Parlamentit gjatë gjithë procesit mbetet e rëndësishme në mënyrë që të sigurohet kontrolli efektiv mbi transparencën dhe përfshirjen gjithëpërfshirëse gjatë negociatave. Parlamenti do të realizojë kështu një nga rolet e tij më kryesorë atë të: monitorimit dhe kontrollit.
- Struktura e negociatave mund të rishikohet dhe përshtatet, duke qenë që ajo është miratuar para se të propozohet Metodologjia e re e Zgjerimit. Kështu që për të adresuar në mënyrë efektive dhe në mënyrë të plotë të gjitha elementet kryesore e inovatore të metodologjisë kjo strukturë duhet tu përshtatet këtyre ndryshimeve.

Për Shoqërinë Civile:

- Sektori i organizatave të shoqërisë civile duhet të punojë për të rritur kapacitetet e stafit dhe ekspertizën në mënyrë që të luajë rolin e tij monitorues dhe vlerësues ndaj procesit të anëtarësimit dhe negociatave. Kjo mund të realizohet me anë të organizimit të trajnimeve dhe aktiviteteve informues; nëpërmjet bashkëpunimit të gjerë e të ngushtë mes OSHC-ve kombëtare por dhe rajonale; nëpërmjet ndarjes së eksperiencave dhe *know-how* me vendet e rajonit tanimë pjesë e BE-së.
- Shoqëria Civile duhet të jetë më aktive për të marrë pjesë në tryezat e këshillimit dhe diskutimit në kuadër të Platformës së Partneritetit. Edhe pse mund të ketë vështirësi në qasjen e informacionit sa i përket Platformës dhe mënyrës së përfshirjes nga strukturat shtetërore përgjegjëse, edhe vet Shoqëria Civile duhet të jetë më e përfshirë dhe vokale që të informohet e të bëhet pjesë e këtyre hapësirave dhe mundësive përfshirjeje.
- OSHC-të duhet të monitorojnë aktivisht procesin e integritetit bazuar në një qasje me dy objektiva kryesore: 1) Monitorimi i procesit duhet të çojë në një vlerësim të tij dhe ofrim rekamandimesh sesi mund të përmirësohet dhe 2) Duhet monitorim dhe i nivelit të zbatimit të rekomandimeve që OSHC-të ofrojnë.
- Komunikimi me qytetarët është kyç për tu ofruar atyre sa më thjeshtë dhe qartë informacion mbi procesin e bisedimeve që është teknik dhe i komplikuar. Duke ofruar këtë informacion te publiku i gjerë dhe të gjithë qytetarët bëhet e mundur që të gjitha sferat e shoqërisë të kenë mundësi të thonë fjalën e tyre e të jenë më aktive duke pasur edhe aftësinë për të vlerësuar procesin gjithashtu.

- Nuk mjafton vetëm bashkëpunimi me institucionet publike; bashkëpunimi duhet të fuqizohet edhe mes OSHC-ve. Shembull pozitiv është vet Qendra Kombëtare Burimore për SHC në Shqipëri, që synon të fuqizojë sektorin e shoqërisë civile duke ofruar informim dhe shërbime të tjera për ti bërë organizatat më efektive, të pavarura dhe transparente si dhe të mundësoj pjesëmarrjen e tyre në proceset demokratike dhe atë të integritetit në BE. Një bashkëpunim më i ngushtë duhet dhe mes aktorëve të shoqërisë civile nga vende të rajonit që ndajnë të njëjtat qëllime dhe objektiva, pasi dhe proceset dhe konteksti i shteteve të BP janë të ngjashme.

Për Bashkimin European:

- BE duhet të vazhdojë të mbështesë dialogun dhe bashkëpunimin mes institucioneve shtetërore dhe OSHC-ve duke ofruar rekomandime si mund të jetë i suksesshëm dhe efektiv; duke hartuar dhe zhvilluar programe që synojnë fuqizimin e këtij bashkëpunimi dhe duke ofruar praktikën më të mira nga Shtetet Anëtare dhe vet BE që mund të ndiqen dhe nga aktorët shqiptarë.
- BE duhet gjithashtu të monitorojë nivelin e transparencës të këtij procesi dhe në mënyrë periodike të ofrojë vlerësime dhe rekomandime, vetëm në këtë mënyrë do të ketë një angazhim konkret dhe konsistent të gjithë aktorëve të përfshirë.
- Është thelbësore për progresin në integrimin e vendeve të BP në BE që procesi të jetë i besueshëm dhe Bashkimi European të mbajë premtimet dhe të angazhohet. Procesi është kompleks dhe përfshin shumë aktorë dhe interesa që jo gjithmonë përputhen, por rreziku nga 'lodhja nga zgjerimi' mund të minimizohet vetëm nëse BE premtim dhe ofron, dhe interesat politike dhe kombëtare të vendeve të BE-së nuk ndikojnë negativisht gjatë tij.
- Edhe pse Komisioni European ka miratuar një strategji që synon promovimin e shoqërisë civile dhe përforsimin e dialogut, BE nuk e monitoron progresin e bërë për të arritur këto qëllime, dhe as nuk vlerëson politikat e marra nga shtetet kandidate. Bashkimi European duhet të përfshihet më shumë në ofrimin jo vetëm të rekomandimeve por edhe të udhëzimeve dhe përcaktimit të kriterëve që duhen plotësuar dhe arritur si nga strukturat shtetërore ashtu dhe ato të shoqërisë civile. Deri më tani nuk është realizuar një sistem vlerësimi periodik vlerësimi për këto strategji dhe politika.
- Mbështetja financiare duhet të vazhdojë, ndërkohë që shtohen elementet e reja të prezantuara nga Metodologjia, me fokus mbështetjen e vazhduar ndaj Shoqërisë civile dhe sistemin e shpërblimeve në raste kur procesi do të ecë pa probleme dhe do të ketë sukses të dukshëm dhe të prekshëm.

ANEKSE

Aneks 1:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 113, datë 30.8.2019

PËR

FORMAT E PJESËMARRJES, FUNKSIONIMIN DHE STRUKTURËN INSTITUCIONALE TË PLATFORMËS SË PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të kreut IX, të vendimit nr.749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian",

URDHËROJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian e cila ka si qëllim:

- a) të rrisë ndërgjegjësimin publik në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- b) të shpjegojë ndikimin e procesit të anëtarësimit për vendin dhe shoqërinë;
- c) të informojë mbi procesin e negociatave dhe procesin e bërë për çdo fazë, duke krijuar mundësi për përthithjen e ekspertizës vendase në fushat përkatëse;
- ç) të mbështesë një përfaqësim gjithëpërfshirës të të gjithë partnerëve, publikë dhe privatë, në procesin e stabilizim-asociimit dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- d) të mundësojë aksesin e shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike dhe të grupeve të interesit, për këshillim e monitorim në

fazat e programimit e zbatimit të asistencës së Bashkimit Evropian për procesin e integrimit evropian.

2. Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian mbështetet dhe funksionin në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për të drejtën e informimit, si dhe njoftimit e konsultimit publik.
3. Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian zhvillon procesin e informimit dhe konsultimit në lidhje me:
 - a) projektqëndrimin negociues të Republikës së Shqipërisë për kapitullin përkatës të *acquis*;
 - b) programimin dhe monitorimin e ndihmës së Bashkimit Evropian;
 - c) hartimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian ose të planeve të tjera në kuadër të procesit të integrimit evropian;
 - ç) çështje të tjera të cilat duhet të këshillohen me strukturat joshpërndarë të përfaqësimit publik, në kuadër të procesit të integrimit.

II. FORMAT E PJESEMARRJES

1. Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian organizohet me dy nivele përfaqësimi:

- a) Bordi drejtues, i cili drejton Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian.

Bordi drejtues të kryesohet nga Kryeministri dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ketë në përbërje të tij 15 anëtarë, si më poshtë vijon:

- i. Zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- ii. Kryenegociatorin;
- iii. Drejtuesin e Sekretariatit të Integrimit Evropian;
- iv. Drejtorin përgjegjës për bashkëpunimin territorial për zbatimin e projekteve IPA;
- v. Drejtori përgjegjës për koordinimin e programeve kombëtare dhe rajonale të IPA-s;
- vi. Dy përfaqësues të shoqatave të organeve të pushtetit vendor;
- vii. Dy përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile;
- viii. Dy përfaqësues të komunitetit të biznesit;
- ix. Dy përfaqësues të shoqatave të punëmarrësve;
- x. Dy përfaqësues të botës akademike.

- b)33 tryeza të diskutimit dhe të këshillimit, të cilat krijohen në mënyrë analoge me kapitujt e “*acquis*” të Bashkimit Evropian.

III. FUNKSIONIMI

III.1. Funkcioni i bordit drejtues

1. Bordi drejtues është struktura më e lartë e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, që garanton bashkëpunimin institucional me grupet e interesit dhe marrjen në konsideratë apo vlerësimin e opinioneve, të qëndrimeve dhe të ekspertizës së tyre për procesin e integrimit evropian.
2. Kryetari i bordit drejtues, përveç funksioneve të tjera, drejton mbledhjet, propozon rendin e ditës, drejton diskutimet në lidhje me qëndrimet gjithëpërfshirëse për procesin e integrimit evropian.
3. Bordi drejtues, pasi mbledh sugjerimet nga tryezat, miraton me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje rregullore brendshme, ku përcaktohen procedurat e detajuara të funksionimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian.
4. Anëtarët e bordit drejtues të përmendur në nënndarjet vi, vii, viii. ix dhe x, të shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut II, zgjidhen nga anëtarët e të gjithë tryezave. Mandati i tyre është 3-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
5. Bordi drejtues mbledhet të paktën çdo tre muaj, megjithatë kryetari mund të kërkojë mbledhjen e bordit drejtues në çdo rast, sipas nevojave të procesit.
6. Bordi drejtues mbështetet nga Sekretariati i Integrimit Evropian.
7. Bordi drejtues miraton raportin vjetor mbi funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian.

III.2. STRUKTURA INSTITUCIONALE

1. Qëllimi kryesor i secilës tryezë është të diskutojë, të shqyrtojë dhe të ndërmarrë qëndrime dhe rekomandime drejtuar institucioneve. Sekretariatit të Integrimit Evropian e strukturave të tjera përgjegjëse në procesin e integrimit evropian, për çështjet e fushat specifike që trajtojnë. Tryezat, gjithashtu, këshillohen në lidhje me programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e asistencës së Bashkimit Evropian për Shqipërinë.

2. Tryezat kryesohen nga drejtuesit e grupeve ndërinstitucionale të punës e koordinohen nga ministritë dhe institucionet kryesuese të kapitujve, sipas fushës së kompetencës së tyre.
Secila nga tryezat e diskutimit dhe të këshillimit ka në përbërje të saj përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të medias dhe të grupeve të interesit.
3. Në takimet e tryezave të diskutimit dhe të këshillimit, në varësi të tematikës së mbledhjes, ftohen të marrin pjesë edhe negociatorët sipas kapitujve negociues dhe koordinatorët e Sekretariatit të Integrimit Evropian.
4. Për të qenë anëtarë në secilën prej tryezave, ftohen të marrin pjesë lirisht përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të medias dhe të grupeve të interesit.
5. Aplikimi për t'u bërë pjesë e tryezave kryhet nëpërmjet dorëzimit të një letre interesi si dhe CV-je të personit apo të grupimit që përfaqëson, ku tregohet se kanë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezën/at specifike.
6. Për ngritjen e tryezave, pranimi apo refuzimi i aplikimeve bëhet nga grupet ndërinstitucionale të punës. Në rastin e anëtarëve të rinj, pranimi ose refuzimi i aplikimit bëhet nga drejtuesit e grupeve ndërinstitucionale të punës. Refuzimi i aplikimit mund të jetë gjithmonë i arsyetuar.
7. Përfaqësimi i tryezave në bordin drejtues bëhet përmes zgjedhjes nga të gjithë anëtarët e tryezave të ngritura të dy përfaqësuesve për secilën prej kategorive të përcaktuara në nënndarjet vi, vii, viii, ix, dhe x, të shkronjës "a", të pikës1, të kreut II, të këtij urdhri. Dy kandidatët e secilës kategori më shumë të votuar nga anëtarët e tryezave të pranishëm në votim përzgjidhen në bordin drejtues. Një pjesëtar i tryezave voton vetëm një herë, pavarësisht se është anëtar në më shumë se një tryezë. Kandidatët për t'u zgjedhur në bordin drejtues mund të propozohen nga anëtarët e tryezave ose të vetëpropozohen.
8. Tryezat mbledhen sipas nevojës nga drejtuesit e grupeve ndërinstitucionale të punës, duke caktuar periodicitet nëse shihet e arsyeshme, por jo më pak se një herë në muaj, ose mbledhen me kërkesë nga të paktën një e treta e anëtarëve.

IV. DISPOZITË E FUNDIT

Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të gjitha institucionet kryesuese të grupeve ndërinstytucionale të punës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

A large, stylized handwritten signature in black ink is written over the printed name 'EDI RAMA' and extends upwards into the space of 'KRYEMINISTRI'. The signature is fluid and sweeping, with a long horizontal stroke extending to the right.

Aneks 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr.749, dt.19.12.2019

PËR
KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURËS SHTETËRORE
PËRGJEGJËSE PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE DHE PËRFUNDIMIN E
TRAKTATIT TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN
EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

2. Struktura e negociatave ka si qëllim arritjen e këtyre objektivave:

- a) realizimin e procesit të shqyrtimit të përafrimit dhe të vlerësimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian (*screening*);
- b) përcaktimin dhe hartimin e qëndrimeve negociuese të Republikës së Shqipërisë për secilin kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian;
- c) negociimin dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

II. STRUKTURA E NEGOCIATAVE

1. Struktura përgjegjëse për negociatat përbëhet nga:

- a) Komiteti Shtetëror për Integrimin Evropian;

- b) Delegacioni Shtetëror;
- c) grupi negociator;
- d) ç) Misioni i Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- e) Sekretariati i Integritimit Evropian;
- dh) grupet ndërinstitucionale të punës;
- e) Platforma e Partneritetit për Integritimin Evropian.

2. Organizimi, veprimtaria, funksionimi dhe bashkërendimi i punës së strukturave midis njëra-tjetrës dhe më gjerë kryhen me akt të veçantë.

III. KOMITETI SHETËROR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Komiteti Shtetëror për Integritimin Evropian krijohet si organi më i lartë që siguron mbikëqyrjen e strukturës së negociatave dhe bashkërendimin e qëndrimit negociues për secilin kapitull të *acquis*, përpara miratimit nga Këshilli i Ministrave.

2. Komiteti Shtetëror për Integritimin Evropian drejtohet nga Kryeministri dhe në të marrin pjesë:

- a) Kryetari i Delegacionit Shtetëror;
- b) Kryenegociatori;
- c) ministrat përgjegjës për çështjet e brendshme, të ekonomisë, financës dhe drejtësisë;
- ç) Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

3. Në Komitetin Shtetëror për Integritimin Evropian merr pjesë, gjithashtu, ministri që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, si dhe ftohen të marrin pjesë kryetarët e institucioneve të pavarura, sipas tematikës së diskutimit për secilin kapitull të *acquis*.

4. Komiteti Shtetëror për Integritimin Evropian mbështetet nga grupi negociator, siç përcaktohet në kreun V, të këtij vendimi. Procedurat dhe organizmi i punës së Komitetit Shtetëror për Integritimin Evropian miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për Evropën dhe Punët e Jashtme.

5. Komiteti Shtetëror për Integritimin Evropian vlerëson dhe bashkërendon qëndrimin negociues për secilin kapitull të *acquis*, të paraqitur nga Kryenegociatori, sipas përcaktimit në pikën 5, të kreut V, të këtij vendimi, me opinionin e Këshillit Kombëtar për Integritimin Evropian.

6. Komiteti Shtetëror për Integritimin Evropian orienton ministrin që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore për kapitullin përkatës të *acquis* dhe Kryenegociatorin për propozimin për qëndrimin negociues që do t'i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave.

7. Këshilli i Ministrave miraton qëndrimin negociues për secilin kapitull të *acquis*, me propozimin e ministrit që mbulon fushën e përgjegjësisë shtetërore për kapitullin përkatës të *acquis*, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të kreut VIII, të këtij vendimi.

IV. DELEGACIONI SHETËROR

1. Delegacioni Shtetëror është organi përgjegjës për zhvillimin e dialogut politik dhe të negociatave me institucionet e Bashkimit Evropian, përfshirë hapjen dhe mbylljen e negociatave

për secilin kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian.

2. Delegacioni shtetëror përbëhet nga:

- a) ministri përgjegjës për punët e jashtme, në funksionin e kryetarit;
- b) Kryenegociatori, në funksionin e zëvendëskryetarit;
- c) kreu i Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian;
- ç) përfaqësues të ministrave dhe të institucioneve të tjera qendrore, në varësi të fushës së përgjegjësisë shtetërore që është objekt diskutimi me institucionet e Bashkimit Evropian.

3. Delegacioni Shtetëror është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe vepron në përputhje me qëndrimet negociuese të miratuara prej tij, sipas përcaktimit të pikës 6, të kreut III, të këtij vendimi.

4. Delegacioni Shtetëror përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Konferencën Ndërqeveritare Shqipëri - Bashkimi Evropian, në kuadër të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian.

5. Në ushtrimin e funksioneve të tij, delegacioni shtetëror mbështetet nga grupi negociator dhe Sekretariati i Integritimit Evropian.

V. GRUPI NEGOCIATOR

1. Grupi negociator krijohet si organi përgjegjës për zhvillimin e procesit teknik të negociatave të aderimit me institucionet e Bashkimit Evropian për çdo kapitull të *acquis*.

2. Grupi negociator përbëhet nga Kryenegociatori dhe jo më pak se 7 (shtatë) anëtarë. Përbërja e grupit negociator, trajtimi financiar e rregullat e funksionimit të tij dhe detyrat e Kryenegociatorit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

3. Grupi negociator ka përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

- a) diskuton dhe vlerëson projektpropozimet për qëndrimet negociuese të hartuara nga grupet ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të *acquis* dhe më pas i dërgon ato për shqyrtim në Komitetin Shtetëror për Integritimin Evropian;
- b) zhvillon procesin e diskutimeve e të negociatave për çdo kapitull të *acquis*, në përputhje me qëndrimet negociuese të miratuara nga Këshilli i Ministrave;
- c) monitoron dhe bashkërendon zbatimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të dokumenteve strategjike për procesin e Integritimit Evropian;
- ç) ndjek zbatimin e kërkesave dhe të udhëzimeve të Komitetit Shtetëror për Integritimin Evropian;
- d) raporton në Komitetin Shtetëror për Integritimin Evropian për veprimtaritë në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian;
- dh) drejton procesin e përditësimit të planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- e) vlerëson dhe finalizon dokumentet dhe raportet e përgatitura në kuadër të takimeve të Komitetit dhe nënkomiteve të stabilizim-asociimit;
- ë) vlerëson ndikimin në financat publike të buxhetit të shtetit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- f) vlerëson ndikimin e përafrimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis*;

- g) vlerëson përparësitë e programit të Bashkimit Evropian të Asistencës (IPA), ecurinë e projekteve të financuara nga programet e Asistencës së Bashkimit Evropian apo nga donatorë të tjerë në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- gj) çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me akt të veçantë.
4. Kryenegociatori i paraqet për opinion Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian qëndrimin negociues për secilin kapitull të *acquis*, të përgatitur nga grupi ndërinstitucional i punës përkatës.
5. Kryenegociatori i paraqet për shqyrtim Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian qëndrimin negociues për secilin kapitull të *acquis*, të përgatitur nga grupi ndërinstitucional i punës përkatës, së bashku me opinionin e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian.
6. Anëtarët e grupit negociator bashkëkryesojnë nënkomitetet e stabilizim-asociimit Shqipëri-BE.
7. Grupi negociator mbështetet në funksionet e tij nga Sekretariati i Integritimit Evropian, siç përcaktohet në kreun VII, të këtij vendimi.

VI. MISIONI I SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian është përgjegjës për:

- a) mbështetjen e komunikimit diplomatik dhe teknik me institucionet e Bashkimit Evropian dhe me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian;
- b) organizimin e agjendës së takimeve dhe të shkëmbimit të qëndrimeve përkatëse të palëve për çështjet e diskutuara në kuadër të negociatave për çdo kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian.

VII. SEKRETARIATI I INTEGRIMIT EVROPIAN

1. Sekretariati i Integritimit Evropian (Sekretariati) përbëhet nga nëpunës diplomatë dhe civilë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.
2. Sekretariati është përgjegjës për koordinimin e politikave kombëtare me ato të Bashkimit Evropian dhe ofron asistencë teknike e administrative për Komitetin Shtetëror për Integrimin Evropian, Delegacionin Shtetëror, grupin negociator dhe grupet ndërinstitucionale të punës në përgatitjen e negociatave për secilin kapitull të *acquis*.
3. Sekretariati i Integritimit Evropian, përveç detyrave funksionale në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, ushtron edhe këto funksione:
 - a) bashkërendon dhe mbështet aktivitetin e grupeve ndërinstitucionale të punës si në kuadër të detyrimeve të procesit të stabilizim-asociimit, ashtu edhe në kuadër të procesit të negociatave për çdo kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian;
 - b) bashkërendon dhe mbështet hartimin e raportit analitik përfundimtar të harmonizimit të legjislacionit vendas me *acquis* të Bashkimit Evropian (*screening*) nga secili grup ndërinstitucional pune, siç përcaktohet në kreun VIII, të këtij vendimi;
 - c) mbledh dhe përpunon projektpropozimet për qëndrimet negociuese për çdo kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian, sipas projektpropozimeve dhe qëndrimeve negociuese të hartuara nga secili grup ndërinstitucional pune, siç përcaktohet në kreun VIII, të këtij vendimi;

ç) koordinon ndërveprimin dhe shkëmbimin e qëndrimeve negociuese e të dokumentacionit përkatës ndërmjet Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian, Delegacionit Shtetëror, grupit negociator dhe Kryenegociatorit me grupet ndërinstytucionale të punës;
d) administron bazën e të dhënave elektronike për monitorimin e procesit të negociatave dhe të detyrimeve që rrjedhin prej tij;
dh) kryen funksione të tjera teknike dhe administrative, që përcaktohen nga kryetari i Delegacionit Shtetëror dhe Kryenegociatori, në kuadër të procesit të negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

4. Sekretariati i kryen funksionet E tij nën udhëzimet e Kryenegociatorit.

5. Rregullat e funksionimit të Sekretariatit të Integrit Evropian miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e Integrit Evropian dhe Punët e Jashtme.

VIII. GRUPET NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Për secilin kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian krijohet një grup ndërinstytucional pune.

2. Grupet ndërinstytucionale të punës janë përgjegjëse për:

- a) analizën e politikave, të legjislacionit, financimit, investimeve, procedurave administrative, ndërveprimit social e të sipërmarrjes private dhe të zbatimit gjyqësor për fushën përkatëse, të mbuluar nga kapitulli përkatës i *acquis*;
- b) përgatitjen e vlerësimit analitik të harmonizimit të legjislacionit vendas me *acquis* të Bashkimit Evropian;
- c) përgatitjen e propozimeve për qëndrimet negociuese për çdo kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian dhe përcjelljen e tyre te grupi negociator;
- ç) përgatitjen e dokumentacionit dhe të raporteve vlerësuese për piketat paraprake (*opening benchmarks*) dhe piketat përfundimtare (*closing benchmarks*) për kapitullin përkatës, duke përfshirë edhe diskutimet apo qëndrimet e dala në negociatat për atë kapitull;
- d) analizimin në mënyrë periodike të kapaciteteve administrative dhe rekomandimin për forcimin e tyre, kur është e nevojshme;
- dh) përcaktimin, në konsultim me anëtarin e grupit negociator përgjegjës për kapitullin përkatës, të prioritetëve të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe përditësimin periodik të këtij përafrimi;
- e) çdo detyrë tjetër, në kuadër të përgatitjes dhe zhvillimit të negociatave të aderimit në Bashkimin Evropian, sipas kërkesës së Kryenegociatorit apo të kryetarit të Delegacionit Shtetëror.

3. Përgjegjësitë e ministrive të linjës apo të institucionit të pavarur në secilin grup ndërinstytucional pune dhe struktura e tyre caktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

4. Strukturat e integrit evropian në ministritë, institucionet e pavarura dhe institucionet në varësi të Kryeministrit/ministrave, mbështesin funksionimin e secilit grup ndërinstytucional pune, në cilësinë e sekretariatit teknik të tij, sipas fushës së kompetencës, nëpërmjet koordinimit të strukturave të institucionit ku ato bëjnë pjesë, sa herë i kërkohet nga kryetari i grupit ndërinstytucional të punës përkatës.

5. Grupi ndërinstitucional i punës kryesohet nga një zëvendësministër ose sekretari i përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse, në varësi të fushës së kompetencës dhe lidhjes së saj me kapitullin përkatës të *acquis* të Bashkimit Evropian apo përfaqësuesi i institucionit të pavarur, kur fusha e kompetencës për kapitullin e caktuar të *acquis* i takon një institucioni të pavarur.

6. Kryetari i secilit grup ndërinstitucional të punës administron grupin e punës në përputhje me kërkesat e anëtarit të grupit negociator përgjegjës për negociatat për kapitullin në fjalë. Kryetari i grupit ndërinstitucional të punës është përgjegjës për veprimtarinë e tij tek anëtari përkatës i grupit negociator përgjegjës për koordinimin e një kapitulli negociues të veçantë.

7. Kryetari dhe anëtarët e secilit prej grupeve ndërinstitucionale të punës emërohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrave apo drejtuesve të institucioneve të pavarura përgjegjëse. Në përbërjen e grupeve ndërinstitucionale të punës, përveç përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse për secilin kapitull, mund të bëjnë pjesë dhe ekspertë, sipas fushës së tyre të kompetencës.

8. Kryetarët e grupeve ndërinstitucionale të punës organizojnë Komitetin Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës. Rregullat e funksionimit të Komitetit miratohen me urdhër të Kryeministrit.

9. Në funksion të procesit të stabilizim-asociimit, grupet ndërinstitucionale të punës janë përgjegjëse për dorëzimin pranë ministrisë përgjegjëse për Evropën të kontributit:

- a) në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian;
- b) për raportin vjetor të Komisionit Evropian;
- c) për të gjitha raportet periodike në lidhje me procesin e stabilizim-asociimit;
- ç) për 7 nënkomitetet e stabilizim-asociimit;
- d) për takimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit;
- dh) për takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit.

IX. PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1. Informimi, konsultimi, komunikimi dhe përfshirja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, sindikatave, botës akademike dhe organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian si dhe në procesin e stabilizim-asociimit realizohen nëpërmjet Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian.

2. Pjesëmarrja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, biznesit, sindikatave, botës akademike dhe organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian për monitorimin e politikave publike gjatë procesit të negocimit nëpërmjet Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, si dhe dhënia e ekspertizës në fusha të ndryshme të *acquis* të Bashkimit Evropian është e hapur për to, sipas fushës përkatëse të kompetencës.

3. Format e pjesëmarrjes, funksionimi dhe struktura institucionale e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian miratohen me urdhër të Kryeministrit.

X. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Çdo efekt financiar, që mund të lindë nga zbatimi i këtij vendimi, përballohet nga buxheti vjetor, i miratuar për ministritë dhe institucionet zbatuese.
2. Ngarkohen ministritë, institucionet e pavarura dhe institucionet në varësi të Kryeministrit/ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

BIBLIOGRAFIA:

Bechev, D., Bulgaria and Romania's EU Accession: Lessons Learned, August 2020: <http://em-al.org/en/bulgaria-and-romania-s-eu-accession-lessons-learned-dr-dimitar-bechev-august-2020/>

Civil Society in the EU Integration of the Western Balkans,
<https://www.files.ethz.ch/isn/184325/Civil%20Society%20in%20the%20EU%20Integration%20of%20the%20Western%20Balkans.pdf>

Council Conclusions on ENLARGEMENT AND STABILISATION AND ASSOCIATION PROCESS – the Republic of North Macedonia and the Republic of Albania, 25 Mars 2020: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

Delegacioni i BE në Shqipëri, Municipalities in the EU Integration Process of Albania, Raporti I, 2018: <https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/filedownload.pdf>

Faqja zyrtare e BE: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/policy-highlights/civil-society_en

Faqja zyrtare e Komisionit European:
https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_19_6137

Faqja zyrtare e Konventës Kombëtare për Bashkimin European në Serbi:
<https://eukonvent.org/>

Faqja zyrtare e Kuvendit në Shqipëri:
<https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrId=7>

Faqja zyrtare e Kuvendit të Maqedonsë së Veriut: <https://www.sobranie.mk/kuvendi-i-republik-s-s-maqedonis-dhe-parlamenti-evropian.nspx>

Faqja zyrtare e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Kroaci: <http://www.mvep.hr/en/croatia-and-the-european-union/negotiation-process/>

Freedom House, Nations in Transit 2020 -
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/albania_en

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/ipa_ii_2018-040-646_2019-040-647_civil_society_facility_and_media_programme_2018-2019.pdf

https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/doc_guidelines_cs_support1.pdf

Komisioni European (2020), New Enlargement Methodology - Enhancing the accession process – A credible EU perspective for the Western Balkans: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/enlargement-methodology_en.pdf

Ligji Nr. 119/2015 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile"

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në Shqipëri: <http://www.financa.gov.al/ep-content/uploads/2019/10/Ministria-e-Financave-dhe-Ekonomise-6120-1.pdf>

MSA mes Shqipërisë dhe BE: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22009A0428\(02\)&from=EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22009A0428(02)&from=EN)

Nikolovski, I., Civil society organisations and North Macedonia's European integration: Towards strategic participation and transparent accession negotiations, pg. 4, Advocacy Paper No.32/2020, KAS in North Macedonia

Pérez-Solórzano Borragán, Nieves, Civil Society and EU Enlargement - In The Search for Europe. Contrasting Approaches. Madrid: BBVA, 2015 - <https://www.bbvaopenmind.com/en/articles/civil-society-and-eu-enlargement/>

Politico.eu, France proposal: <https://www.politico.eu/wp-content/uploads/2019/11/Enlargement-nonpaper.pdf>

Positions of civil society organizations: A model of negotiations with the EU tailored to society as a whole, North Macedonia: <https://idscs.org.mk/mk/2018/12/13/7559/>

Raporti i KE 2020 për Maqedoninë e Veriut: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf

Raporti i KE 2020 për Shqipërinë: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

Šeperić, Darko. To Europe and Back – The Croatian EU Accession Process and Its Outcomes. SEER: Journal for Labour and Social Affairs in Eastern Europe, vol. 14, no. 4, 2011, pp. 463–480. JSTOR, www.jstor.org/stable/43293436

Transparency in retrospect: preliminary lessons from Croatia's EU accession process
Discussion paper Commissioned by the Greens / EFA in the European Parliament Prepared
by Marina Škrabalo, GONG Research Centre, Croatia, pg. 2, <https://www.franziska-brantner.eu/wp-content/uploads/2012/11/Transparency-in-retrospect.pdf>

Vendimi Nr. 539, datë 25.7.2019: [http://www.amshc.gov.al/web/doc/Udherrefyesi-2019-rishikuar-\[EN\].pdf](http://www.amshc.gov.al/web/doc/Udherrefyesi-2019-rishikuar-[EN].pdf)

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 749, 19.12.2018 *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.”*

Urdhri Nr. 93 i datës 20.05.2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës”*.

Urdhri Nr. 94 i datës 20.05.2019 *“Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”*

Urdhri Nr. 113 i datës 30.08.2019 *“Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian”*



2020

